*UNITED NATIONS*
*United Nations Interim Administration Mission in Kosovo*

*UNMIK*

*NATIONS UNIES*
*Mission d'Administration Intérimaire des Nations Unies au Kosovo*

*PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT*

**KUVENDI I KOSOVËS**
**СКУПШТИНА КОСОВА**
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

# *T R A N S K R I P T*

*I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 18-19 SHKURT 2004*

*PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE 18 -19.02.2004. GODINE*

*SHKURT - FEBRUAR*
*2004*

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo

UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

# KUVENDI I KOSOVËS
# СКУПШТИНА КОСОВА
# ASSEMBLY OF KOSOVO

## RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transportin e mallërave të rrezikshme,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për materialin fidanor,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Odën Ekonomike të Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për barazi gjinore,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit kundër diskriminimit,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndetësi,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektlegjislacionit për bashkëpunim me Tribunalin Penal të Hagës,
9. Shqyrtimi i veprimit të strukturave paralele në Kosovë,
10. Përgjigjet në pyetjet e deputetëve.

## ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са претходне седнице,
2. Прво разматрање Нацрта закона о транспорту опасних материја,
3. Прво разматрање Нацрта закона о садном материјалу,
4. Друго разматрање Нацрта закона о Привредној комори Косова,
5. Друго разматрање Нацрта закона о Полној равноправности,

6. Друго разматрање Нацрта закона против дискриминације,
7. Друго разматрање Нацрта закона о здравству,
8. Друго разматрање Нацрта закона о сарадњи са Кривичним Трибуналом у Хагу,
9. Разматрање деловања паралелних структура на Косову,
10. Одговори на посланичка питања.

## AGENDA

1. Approval of the minutes from the previous meeting,
2. First reading of the Draft Law on Transport of Dangerous Goods,
3. First reading of the Draft Law on Propagation Material,
4. Second reading of the Draft Law on Economical Chamber of Kosovo,
5. Second reading of the Draft Law on Gender Equality,
6. Second reading of the Draft Law on Anti Discrimination,
7. Second reading of the Draft Law on Health,
8. Second reading of the Draft Legislation regarding to cooperation with Tribunal of Hag,
9. Review on the operation of parallel structures in Kosovo,
10. Responses on the deputies questions.

# *TRANSKRIPT*

## *I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 18 -19 SHKURT 2004*

*Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës u mbajt në Sallën plenare të Kuvendit të Kosovës.*

*Seancën e kryesoi Akademik Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës. Bashkëkryesues Hydajet Hyseni, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.*

*Seanca filloi punën në orën 11,00.*

***KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:***

***(Kështu fillon transkriptimi i Seancës nga inçizimi elektronik)***

*.......Gjatë procedimit, në qoftë se aprovohen amendamentet e të dy palëve apo tri palëve, të gjitha amendamentet janë konfrontuese në përmbajtje njëri me tjetrin dhe do të dilte një ligj krejtësisht i paaplikueshëm.*

*Andaj, meqë edhe ashtu është zgjatur dhe po ashtu kemi shumë probleme tjera teknike, do t'ju lutja për mirëkuptim dhe vendimi i këtij Komisioni do të jetë definitiv: – ligji ose do të vjen në seancë për aprovim, e pastaj nëse propozojnë diçka tjetër, do të jetë një propozim definitiv.*

*Unë do t'ju lusja për mirëkuptim. Kryetarët e grupeve parlamentare, sipas radhës, e kanë të drejtën për diskutim. E ka fjalën profesor Sabri Hamiti, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.*

***SABRI HAMITI:***

*Zotni kryetar i Kuvendit të Kosovës, deputetë - kolegë të nderuar,*

*Unë menjëherë pajtohem me këtë sygjerim të Kryesisë në emër të Grupit Parlamentar.*

*Po menjëherë edhe do të vazhdoj, meqë jemi këtu, me një punë tjetër që duhet ta bëjë shumë shpejt i njëjti Komision – Komisioni për kornizë kushtetuese dhe për legjislacion. Bile, unë kisha thënë që - nëse është e mundur - të mbledhet në afatin sa më të shkurtër të kohës. Fjalën e kam për mënyrën e votimit në këtë Kuvend.*

*Për t'mos ia lënë vullnetit, për t'mos ia lënë punën interpretimeve prej rastit në rast dhe interpretimeve të votimeve – unë jam përpjekur që të kemë përpara dokumentet bazë me të cilat punojmë ne deri tash – Kornizën kushtetuese, e cila thotë në nenin 9.3.37: "Projektligji miratohet nëse merr shumicën e votave të atyre që janë të pranishëm dhe që votojnë". Kjo është Rregulla 9.1.37.*

*Rregullorja jonë e Kuvendit, me të cilën ne punojmë, që e kemi aprovuar vetë, në Rregullën 27.3 e keni aty - kush e ka me veti, faqe 16 – thotë: "Vendimet e Kuvendit kërkojnë mbështetjen e shumicës së atyre që janë të pranishëm dhe që votojnë "për" ose "kundër", përveç në rastet kur me këtë Rregullore të punës parashihet shprehimisht ndryshe.".*

*Tutje, shkojmë edhe një hap më tej, sepse shpeshherë kam dëgjuar këtu që ka bigzim në këto rregullore e në një më të hershme, që është e 2001-shit – prap Rregulla 24.3, faqe 23, thotë: "Vendimet e Kuvendit kërkojnë mbështetjen e shumicës së atyre që janë të pranishëm dhe që votojnë "për" ose "kundër".".*

*Unë i dhash tri burimet që ekzistojnë në dokumentet me të cilat ne punojmë. Unë lus – dhe kërkoj, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, që Komisioni në afatin sa më të shpejtë t'i analizojë këto, t'i shqyrtojë dhe të dalë me mendim para Kuvendit. Ju falemnderit shumë.*

***KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:***

*Ju falemnderit shumë. Unë mendoj që të dy këto çështje janë të mira dhe këtë e përkrahi, dhe mendoj se ndoshta nuk duhet të hapim debat, por të procedojmë me punën. Urdhëroni, nëse e sheh të arsyeshme dikush prej grupeve parlamentare? E ka fjalën, profesor Arsim Bajrami.*

***ARSIM BAJRAMI:***

*Më lejoni që fillimisht në emër të Grupit Parlamentar të shpreh pakënaqësinë me ndërrimin e ulseve në Kuvend. Mendoj se ky vendim është pruar padrejtësisht dhe ne nuk e pranojmë. Për të mos dështuar mbledhja, e cila ka dështuar dje pa fajin tonë, ne sot jemi ulur përkohësisht këtu por kërkojmë urgjentisht nga Kryesia e Kuvendit që mos ta neglizhojë këtë problem por të merret me këtë problem dhe dëshirojmë që në sesionin e ardhshëm, çdonjëri prej nesh, ta ketë vendin ku e ka pasë.*

*Ndërrimi i kompozicionit të ulseve në Kuvend nuk duhet të reflektojë edhe ndërrimin e vendeve ku janë ulur deputetët. Inçizimet filmike janë akoma shumë të freskëta dhe mund të shihet kush ku ka qenë ulur. Kërkoj nga Kryesia që këtë ta ketë parasysh dhe për mbledhjen e parë të ardhshme çdonjëri deputet ta ketë emrin para ulses së vet dhe ambienti i ri mos të reflektojë edhe pozicione të reja në Kuvend. Ju po e shihni sot, të gjitha grupet parlamentare janë ulur në pozicione tjera.*

*Ne, për të mos dështuar mbledhja e Kuvendit të Kosovës për këto shkaqe që nganjëherë janë edhe banale - kemi pranuar dhe kemi ardhur në këtë seancë. Por kërkojmë nga Kryesia që mos ta neglizhojë këtë problem, por ta marrë seriozisht dhe zgjidhë këtë çështje. Nuk është vetëm çështje teknike kush ku ulet, por është edhe çështje tjetër, kështu që kërkoj që kjo çështje të zgjidhet sa më shpejt.*

*Sa i përket propozimit të kryetarit për shtyrjen e diskutimit për Projektligjin për Odën Ekonomike jap përkrahje parimore, por edhe në emër të Grupit Parlamentar nuk insistoj në shtyrje të gjatë siç ka ndodhur. Meqenëse ky ligj po na sillet qe një kohë të gjatë, Komisioni për çështje legjislative është i gatshëm që edhe brenda ditës, meqenëse tani po punojmë me sesione dhe kemi kushte më të mira, të tubohet e të jepë mendimin. Vërtetë është i nevojshëm mendimi i këtij Komisioni për shkak se amendamentet kanë ndërruar në koncept këtë ligj dhe në fakt me këto amendamente ligji ka ndërruar objektin e rregullimit, dhe për shkak se neve na është përcjellur nga Qeveria ligji për odën ekonomike - tani me këto amendamente ligji ka ndërrue objektin e rregullimit dhe rregullon edhe asociacione të tjera të biznesit.*

*Pra, në qoftë se ju vlerësoni se kjo është urgjente, ne mundemi shumë shpejt, derisa Kuvendi është i mbledhur, dhe meqë Kuvendi mund do të punojë edhe ditëve të tjera, ta japim këtë mendim dhe kjo çështje të mos shtyhet kështu kohë të gjatë.*

***KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:***

*Ju falemnderit. Unë mendoj se mund të vazhdojmë. I dëgjuam dy propozimet. Ta dëgjojmë edhe zotin Dugolli në emër të Aleancës.*

***BUJAR DUGOLLI:***

*Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës kundërshton këtë metodologji të punës që është bërë prej renovimit të sallës së Kuvendit dhe të gjitha këto pakënaqësi që kanë ndodhur qoftë për ulëse, qoftë për pakënaqësitë që do të ndodhin edhe më vonë me faktorin ndërkombëtar, me pakicat e tjera, sepse konsideroj që është dashur paraprakisht të mblidhen grupet politike dhe Kryesia e të përcaktojnë se si do të duket kjo sallë, si do të duket i tërë ambienti në Kuvendin e Kosovës, dhe jo të shkaktohen probleme të panevojshme.*

*Si do që të jetë, ne si Grup Parlamentar jemi të gatshëm, e që jemi deklaruar edhe më herët – vetëm të tjerët të rrespektojnë metodologjinë edhe të ulseve edhe të punës tjetër në Kuvend, dhe ne nuk do të bëjmë problem.*

*Ne përkrahim që shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Odën Ekonomike të hiqet sot nga procedura sepse ka probleme, siç u përmendën.*

*Dhe për çështjen e votimit... Kjo është një rregull që për disa aspekte ku flitet për votim për disa çështje, amendamente apo projektligje vlenë rregulla që është zbatuar edhe në shumë institucione që shumica e prezentëve 50 plus 1 të aplikohet dhe të mos ketë forma të tjera, përveç rasteve kur është e përcaktuar me Kornizë kushtetuese apo me Rregullore. Mendoj se kjo duhet të saktësohet nga Komisioni që të mos kemi probleme tjera në mbarvajtjen e punës së Kuvendit. Ju falemnderit.*

***KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:***

*Ju falemnderit. Unë mendoj se duhet të vazhdojmë me mënyrën e vjetër meqë një pjesë e deputetëve ende nuk janë trajnuar, por i futni kartelat për shkak që diskutimin ta bëni në vend për të mos dalë këtu. Prandaj, urdhëroni. E ka fjalën shefi i Grupit Parlamentar të të Tjerëve.*

***GANI SADIK:***

*Të falemnderit zoti kryetar.*

*Edhe ne jemi në dilemë, zoti kryetar, se në leximin e parë e patëm... Amendamentet të cilat i kemi marrë nuk përputhen me leximin e parë. Është një huti në mes nesh, dhe ju kisha lutur ta heqni këtë prej rendit të ditës. Ju falemnderit.*

***KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:***

*Ju falemnderit. Ne vetëm u morëm vesh, prandaj vazhdojmë me rendin e ditës. A deshe fjalën? Urdhëro, zoti Hydajet Hyseni e ka fjalën.*

*HYDAJET HYSENI:*

*Unë desha të përshëndes nismën e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike .... të Lidhjes Demokratike, më falni, për ta shqyrtuar edhe një herë çështjen e votimit në Kuvendin tonë. Më vjen mirë që më në fund kjo po kuptohet. Por dua të përkujtoj se kjo çështje ka qenë shtruar edhe në procedurë të rregullt edhe me parashtresë nga deputeti Ismajl Kurteshi. Është shtruar edhe më parë dhe Komisioni për çështje legjislative ka bërë një interpretim të gabuar, në kundërshtim me këtë që po kërkohet. Prandaj, inisiativës do të duhej bashkëngjitur edhe kërkesa për ta rishikuar vendimin e Komisionit i cili dukshëm ka qenë i pabazuar, i gabuar, por është bërë me shumicë votash dhe është pranuar edhe prej atyre që kanë votuar me shumicë votash se është votuar për interesa politike partiake, por jo me qëndrime e motivime parimore. Prandaj, besoj se kjo do të korrigjojë tërë praktikën tonë. Si të tillë, unë e përshëndes.*

*KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:*

*Mua më duhet ta jap një sqarim. Një vit e më tepër sekretar gjeneral i Kuvendit të Kosovës ka qenë njeriu i Parlamentit Francez. Konsultimet e Parlamentit të Australisë, të Irlandës, të Spanjës dhe deri në fund - kur është bërë problem i parëndësishëm - nuk ka pasë asnjë vërejtje, asnjë vërejtje nga ata që kanë këshilluar nga ndërkombëtarët. Nuk ka pasë asnjë vërejtje nga qarqet profesionale juridike që e këshillojnë kryetarin e Kuvendit dhe që janë edhe jashtë Kuvendit.*

*Atë që e tha Bujari është shumë e saktë, shumë e saktë. Tradita në të gjitha institucionet e Kosovës gjithmonë, prej themelimit të tyre, ka qenë ajo që e kemi vazhdue. Me rëndësi është që ka qenë një konstantë për këto dy vjet, a dy vjet e gjysmë - një konstantë. Por, meqë është kërkuar, kurse ne përshëndetëm propozimin e shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike dhe të gjithë u pajtuan që komisioni profesional përkatës për atë çështje ta japë mendimin e vet, dhe si të doni - për këtë dhe në këtë drejtim, nuk ka kurrfarë hamendje.*

*Unë po ju them, me bindjen e thellë profesionale të krejt Evropës dhe të qarqeve profesionale në Kosovë, të qarqeve më të larta profesionale, nuk ka patur gabime. Por, si do që të merremi vesh, kryesore është të fillojmë dhe të ecim, kurse gjatë ecjes gjithmonë ka vend që proceset të korrigjohen dhe mos t'i ndalim proceset, siç ngjau me privatizimin, por të korrigjohemi në ecje.*

*Prandaj, kalojmë në miratimin e Procesverbalit.*

*Në qoftë se dikush ka vërejtje, ato si gjithmonë duhet bërë me shkrim dhe përnjëherë kalojmë në – Shqyrtimin e parë të Projektligjit për transportin e mallrave të rrezikshme.*

*Ftoj ministrin - sponsor të ligjit - që ta marrë fjalën. Zoti ministër foltorja është e juaja.*

*ZEF MORINA:*

*I nderuari zoti kryetar, Kryesi e nderuar, zonja dhe zotërinj deputetë,*

*Në pajtim me Kreun e pestë, paragrafi 5.1 të Kornizës kushtetuese dhe Rregullores së UNMIK-ut 2001/19 Ministria e Transportit dhe e Posttelekomunikacionit ka ndërmarrë inisiativë ligjore për hartimin e ligjit mbi transportin e mallrave të rrezikshme.*

*Ky Projektligj është përgjigje ndaj nevojave për një ligj moderrn dhe gjithpërfshirës për sektorin e transportit të mallrave të rrezikshme, nevoja të cilat janë identifikuar si disa nga prioritetet më të larta të Ministrisë në Programin e saj për krijimin e legjislacionit për këtë vit.*

*Me qëllim të zbatimit të objektivave të parashtruara, Ministria kohë më parë ka formuar Grupin punues për projektimin e ligjit mbi transportin e mallrave të rrezikshme nga ekspertët vendor dhe ndërkombëtar.*

*Ky Projektligj promovon konsolidimin e strukturave përgjegjëse në sektorin e transportit të mallrave të rrezikshme për arsye se sqaron përgjegjësitë dhe kompetencat përkatëse të subjekteve që mbajnë përgjegjësi në sektorin në fjalë.*

*Ky Projektligj promovon zhvillimin e sektorit t ë transportit t ë mallrave të r rezikshme p ërmes themelimit të një kornize ligjore rregullative e cila përputhet me standardet dhe praktikat ndërkombëtare.*

*Ky Projektligj ngritë nivelin e transparencës dhe efikasitetit në sektorin e transportit të mallrave të rrezikshme.*

*Ministria do të krijojë dhe implementojë politikën dhe strategjinë e sektorit në fjalë - të miratuar nga Qeveria në bazë të procedurave transparente.*

*Projektligji në fjalë krijon kushtet që gjatë transportit të mallrave të rrezikshme të adaptohen teknologjitë e fundit dhe standardet profesionale të ADR-ës me qëllim të parandalimit të rrezikut gjatë transportit të mallrave të rrezikshme. Gjatë transportit të mallrave të rrezikshme barten substanca dhe objekte të cilat mund të shkaktojnë rrezik për sigurinë publike, jetën dhe shëndetin e njerëzve, të kafshëve në saje të karakteristikave të tyre gjatë transportimit.*

*Projektligji mbi transportin e mallrave të rrezikshme është i nevojshëm si vijon:*

- *me qëllim të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të njerëzve gjatë transportit të*
- *mallrave të rrezikshme;*
- *shtimit të sigurisë publike;*
- *adaptimit të legjislacionit europian si ADR;*
- *adaptimit të të arriturave shkencore dhe teknologjike në këtë lëmi;*
- *vendosjen e standardeve më të larta të sigurisë;*
- *nxitjen e konkurrencës;*
- *rritjen e profesionalizimit;*
- *zhvillimin e ekonomisë së tregut;*
- *për ofrimin me politikat e Unionit Evropian në transport si "dokumenti i bardhë",*
- *politika e Unionit Evropian në transport deri në vitin 2010;*
- *mbrojtjen e mjedisit, e tjerë.*

*Projektligji do t'i adresojë problemet si vijon:*

- *rreziku nga eksplodimi;*
- *rreziku nga zjarri;*
- *rreziku i kontaminimit për të gjithë ata që janë të përfshirë në transport;*
- *dëmtimi i mjedisit;*
- *rreziku i korrozioinit, e tjerë.*

*Gjatë hartimit dhe shqyrtimit të mëtejmë të Projektligjit në fjalë Ministria është koordinuar edhe me ministritë tjera me qëllim që ekspertët e ministrive përkatëse të marrin pjesë në grupet punuese, si me:*

- *Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave;*
- *Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor;*
- *Ministrinë e Shërbimeve Publike; dhe*
- *Ministrinë e Shëndetësisë.*

*Kontribut të madh në hartimin e këtij Projektligji kanë dhënë edhe këshilltarët ligjor të UNMIK-ut.*

*Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit gjatë hartimit të Projektligjit në fjalë ka bashkëpunuar ngusht me UNMIK-un lidhur me çështjet që prekin kompetencat e pushtetit të rezervuar për PSSP-ën me qëllim të harmonizimit të qëndrimeve në faza të hershme për çështjet eventuale të diskutueshme.*

*Ligjet e ish-Jugosllavisë mbi transportin e mallrave të rrezikshme të vitit 74 dhe 84 nuk janë të harmonizuara me standardet evropiane të legjislacionit në këtë sektor, siç është ADR.*

*Ligjet e ish-Jugosllavisë për transportin e mallrave të rrezikshme janë të tejkaluara dhe nuk krijojnë mundësi për tejkalimin e problemeve të sektorit të transportit të mallrave të rrezikshme.*

*Projektligji përbëhet nga këto nene:*

*Nga neni 1 deri 3 përcaktohen synimet e parandalimit të rrezikut, mbikëqyrjen, sigurimin e komunikacionit gjatë transportit të mallrave të rrezikshme; kompetencat dhe përgjegjësitë e autoriteteve përkatëse rreth mbikëqyrjes lidhur me zbatimin e këtij ligji; përkufizimet terminologjike dhe objektin e këtij Projektligji.*

*Nenet 4 deri 6 përcaktojnë se në cilat situata përjashtohet zbatimi i Projektligjit; standardet ndërkombëtare; ku bazohet Projektligji dhe mënyrën ezbatimit të standardeve në fjalë, si dhe obligon objektet e transportit që pa licencë nuk mund të merren me transportin e mallrave të rrezikshme.*

*Nenet 7 deri 9 përcaktojnë autoritetin e Ministrisë së Transportit për klasifikimin e mallrave të rrezikshme, detyrueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare ku autoritetet me kompetencë përkatëse në bashkëpunim me UNMIK-un janë nënshkruese në relacionet e marrëveshjeve në fjalë dhe legjislacionin në fuqi, si dhe transportimi me ambalazhe që garantohet nga çertifikata e prodhuesit.*

*Nenet 10 deri 12 përcaktojnë detyrimet e ndërsjella dhe përgjegjësitë e prodhuesit dhe transportuesit; dokumentacionin e nevojshëm për transportimin e mallrave të rrezikshme; procedurat e caktuara rreth çështjes në fjalë, si dhe ndalimin e transportimit me mjete joadekuate.*

*Nenet 16 deri 18 përcaktojnë përmbajtjen e licencës, revokimin dhe pezullimin e licencës, si dhe autoritetet të cilat janë të përjashtuara në raste të caktuara nga marrja e licencës, siç është KFOR-i, TMK, Policia e UNMIK-ut dhe Shërbimi Policor i Kosovës.*

*Nenet 19 deri 21 përcaktojnë autoritetin e Ministrisë që të nxjerrë rregulla mbi transportin e mallrave të rrezikshme mbi lejimin e paketimit, etiketimit dhe tjera, si dhe edukimin e personave që merren me transportin e mallrave të rrezikshme, masat urgjente lidhur me ndalimin dhe kufizimet e caktuara lidhur me transportin e mallrave të rrezikshme.*

*Nenet 22 deri 24 përcaktojnë masat e sigurisë, refuzimin e transportit të mallrave të rrezikshme, kontrollimin e transportit të mallrave të rrezikshme si dhe masat urgjente lidhur me ndalimin dhe kufizimet e caktuara lidhur me transportin e mallrave të rrezikshme.*

*Nenet 25 deri 27 përcaktojnë ndihmën zyrtare dhe sigurimin e të dhënave, bashkëpunimin me ministritë tjera dhe masat ndëshkimore.*

*Dhe nenet 28 deri 31 përckatojnë procedurat lidhur me ankesat, afatet rreth ankesave në fjalë dhe aktet tjera që duhet të nxjerren për zbatimin e këtij ligji. Ju falemnderit.*

***KRYETAR I KUVENDIT NEXHAT DACI:***

*Ministër ju falemnderit. Dëgjuam arsyetimin e Projektligjit. Ju e dini që radha e paraqitjes së diskutuesve janë: kryetarët e komisioneve, kryetarët e grupeve parlamentare, anëtarët e Kryesisë dhe deputetët sipas radhës së paraqitur. Prandaj, ata që ndiejnë nevojën ose janë të përgatitur të japin kontributin për këtë ligj, le të urdhërojnë.*

*E ka fjalën zoti Jagxhillar. Nëse doni, mundeni prej vendit.*

***MAHİR YAĞCILAR:***

*Ju falemnderit, zoti kryetar.*

*Sayın Meclis Başkanı, sayın bakanlar ve değerli millet vekilleri*

*Önümüzde, insanlar ve çevrenin güvenliği açısından oldukça önemli olan bir Yasa daha bulunmaktadır. Tehlikeli malzemelerin ulaşımına ait Yasa gerekli olduğu için bunu destekliyorum ve aynı zamanda millet vekilleri tarafından desteklenmesi için çağrıda bulunmaktayım.Çevre ve güvenlik için oldukça önemli ve gerekli olmasına rağmen, bu Yasanın iyi olması ve değiştirgeler ile öneriler sayesiyle iyice hazırlanıp, uygulanması gereklidir.*

*Bu açıdan ben, Yasada devamlı tekrarlanan " eğer " kelimesinin en büyük zayıflıklardan biri olduğunu düşünmekteyim.*

*Tehlikeli malzemelerden söz edildiğinde, düşünceme göre bu tehlikeli malzemelerin hangileri olduğu iyice belirtilmelidir, çünkü 7. maddede açıklananalar yeterli değildir.*

*Düşünceme göre 8. 9. ve 12. maddeler birbiriyle uyumlu değildir.*

*Karayolu ulaşımına ait Yasadan sonra, tehlikeli malzemelerin taşınması için iznin istenmesi çoktur gibime geliyor ve bu en iyi belirli ulaşıma ait ruhsatla çözümlenebilir. Bu konu hakkında Bütçe Komisyonunun da düşüncesini vereceğine inanmaktayım.*

*Acil önlemlerin alınmasından bahseden 21. madde daha ayan olmalıdır.*

*27. maddedeki 2 paragrafın burada yer alması gereksizdir, daha doğrusu bu paragraph Yasanın başka maddelerinde yer alabilir.*

*Düşünceme göre 30. madde de pek ayan değil.*

*Ve sonunda şunu belirtmek isterdim ki bu Yasada, taşıtların olması gereken güvenlik hazırlıkları, devinmenin maksimal hızı, gereken sinyalleri, tehlikeli mallar taşıdığına dair işareti, ambalaj kalitesi ve boş ile ışıklandırılmış ambalajların taşınması koşulları belirtilmelidir.*

*Bu Yasa önergesini kabul etmeniz için bir kez daha çağrıda bulunarak, hepinizi selamlıyorum. İlginize teşekkürler.*

***KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:***

*Ju falemnderit shumë. E ka fjalën zoti Bajrush Xhemajli.*

***BAJRUSH XHEMAJLI:***

*Ju përshëndes të gjithëve. Uroj që në këtë sallë të re t'na shkojnë punët më mirë se përpara.*

*Sa i përket Projektligjit për transportimin e mallrave të rrezikshme dhe për rëndësinë e këtij ligji foli ministri. Por mendoj se ishte një shembull tipik, fatkeqësisht sikur edhe dje që pamë eksplodimin në Iran dhe sa jetëra ka marrë pikërisht për këtë shkak që transportimi s'ka qenë i sigurt për mallra të rrezikshme.*

*Këtë Projektligj Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështetë në parim dhe jep vizën për shqyrtim të mëtutjeshëm.*

*Përndryshe, ka disa vërejtje të cilat do të duhej të përmirësohen dhe mirren parasysh gjatë shqyrtimit të dytë. Për shembull, në parim – në nenin 8 për marrëveshjet ndërkombërtare thuhet se "duhet nënshkruar nga personat kompetent të Kosovës në koordinim me UNMIK-un". Do të duhej që këtyre çështjeve, të kësaj natyre ku ka të bëjë me UNMIK-un, do të duhej dhënë ndonjë dispozitë kalimtare të ligjit, po jo të futet në nene, siç është futur këtu, pasi ligji do të duhej shërbyer për kohë shumë të gjatë dhe shumë kompetenca mund të kalojnë shumë shpejt në duart e vendorëve, e edhe kompetenca të tilla, siç janë të shënuara në këtë nen.*

*Në nenin 9 ku bëhet fjalë për transportimin e mallrave të rrezikshme me mjete që nuk i përmbushin kushtet, leja e automjeteve dhe e mjeteve për bartje për dhjetë vite pas hyrjes në fuqi të këtij ligji – është mendoj tejet i madh, tejet i gjatë, meqë automjetet që nuk i plotësojnë kushtet të lejohen të përdoren dhjetë vite është mendoj shumë e rrezikshme, sepse automjeti edhe po të jetë i ri, edhe po t'i plotësojë kushtet - është rrezik të bartë materiale të tilla, e lere më ato që nuk i plotësojnë kushtet.*

*Përpos gabimeve gjuhësore, si zakonisht, është edhe një moskujdes apo një mospërfillje – kisha thënë, e ndoshta edhe mungesë kulture që edhe në tekstin përfundimtar mbetet një laramoni ku, ta zëmë, brenda një fjalie herë është "ë" e herë në vend të saj "w" që është maltretim në vete gjatë tërë leximit të këtij ligji. Mendoj se s'e kemi pasë borxh këtë maltretim. Ju falemnderit.*

***KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:***

*Ju falemnderit shumë. A dëshiron kush tjetër fjalën? E ka fjalën Ramadan Kelmendi.*

*RAMADAN KELMENDI:*

*I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, ministra dhe të pranishëm,*

*Grupi Parlamentar i LDK ka analizuar në kuptimin juridik dhe përmbajtësor propozimligjin për transportimin e mallrave të rrezikshëm dhe në bazë të këtyre rezultateve përkrahë në shqyrtimin e parë si tërësi të paraqitur.*

*Përkrahjen e vet e mbështetë në këto fakte. Në faktin se Kosovës i mungon legjislacioni përkatës me të cilin përcaktohen lëmitë e prodhimit, deponimit dhe të transportimit të materieve të rrezikshme që flet mjaft për arsyeshmërinë e përkrahjes dhe arsyeshmërisë së nxjerrjes së këtij ligji.*

*Megjithatë, më lejoni që t'i paraqes disa vërejtje të cilat po qe se aprovohen do ta begatonin këtë propozimligj.*

*Që në hyrje vërehen dukshëm të metat e gjertanishme teknike dhe gjuhësore, për të cilat nuk do t'isha lëshuar më tepër. Natyrisht qarkullimi i mallrave të rrezikshme nëpër territorin e Kosovës rrezikon jetën e qytetarëve, të botës bimore dhe shtazore si pasojë e mundshme të eksplodimeve, të kontaminimeve, të lirimeve të gazrave helmuese, shkaktimit të zjarreve e tjera. Por propozimligji harron të përcaktojë se qytetarët e Kosovës rrezikohen çdo ditë nga deponime të tjera të prodhimeve industriale të pafinalizuara të cilat vijnë nga rrjedhat lumore të lumit Ibër dhe Sitnicë si rrjedhje natyrore e lumenjve, si për shembull me mbeturina disavjeçare të shkrirjes së plumbit përmes piritit dhe mbeturinave të thëngjillit të Obiliqit përmes pluhurit, fenolit e tjera.*

*Dy. Fatmirësisht në këtë propozimligj përcaktohen disa kufizime të transportimit të mallrave të rrezikshme, por ligji do të mbetet i paaplikueshëm nëse nuk bëhet aftësimi i duhur dhe dhënia e kompetencave të duhura Shërbimit Doganor të Kosovës në pikat doganore dhe Shërbimit Policor të Kosovës që të marrë masa adekuate ligjore për ta ndaluar dhe penguar transportimin e mallrave të rrezikshme nëpër vende hyrëse në hapësira transitore që lidhin Kosovën me pjesët tjera perëndimore dhe me shtetet përrreth.*

*Po ashtu, me këtë propozimligj do të ishte mirë që si mall i rrezikshëm për jetën jerëzore, shtazore dhe bimore të përcaktohen dhe trajtohen edhe barnat apo ilaqet në kuptimin e të gjitha llojeve që iu ka kaluar afati i përdorimit dhe transportohen për nevoja të qytetarëve dhe nevoja tjera nga shtetet fqinj – Serbia, Maqedonia, Turqia, Sllovenia e tjera.*

*Është në natyrën e ligjit që të obligohet prodhuesi, gjegjësisht transportuesi dhe deponuesit e mallrave të rrezikshme dhe të bëjnë shenjëzimin e vendeve të prodhimit, natyrisht të deponimit por edhe gjatë kohës së transportimit, paralajmërimet e popullatës që bëjnë pjesë në momentin e transportimit dhe atë me afate kohore nga se kjo rrezikon qytetarët.*

*Sot në Kosovë disa ndërmarrje të vogla prodhojnë shampon, deterxhent, sapuna dhe këto transportohen me një dozë të rrezikshmërisë për shëndetin, ndërsa propzimligji nuk e shqyrton këtë fare.*

*Vlerësoj se në këtë propozimligj është dashur së pari të kalohet në fazën e transportimit të mallrave të rrezikshëm dhe të përcaktohet si domosdoshmëri e lidhjes së një marrëveshjeje apo kontrate ndërmjet prodhuesit, dërguesit, transportuesit dhe deponuesit duke obliguar që ky proces të përcillet me dokumenta zyrtar të nevojshëm për kohën dhe mënyrën e tarnsportimit dhe njohtimin e populatës së paku 24 orë më herët para se të qarkullojë nëpër atë zonë.*

*Mendoj se nuk është detyrë e Ministrisë që të mirret me edukimin dhe trajnimin e personave që e bëjnë transportimin e mallrave të rrezikshëm, siç e parasheh propozimligji, por të sjellë udhëzim juridik për institucionet profesionale dhe adekuate të cilat do ta kryenin këtë shërbim.*

*Propozimligji në shqyrtim nuk sqaron si dhe kush është kompetent i autorizuar dhe kompetent për kontrollimin e transportimit të mallrave të rrezikshme, si dhe nuk përcakton shkallën e përgjegjësisë për prodhuesit transportues dhe shpërndarësin e mallrave të rrezikshme pa autorizime.*

*Propozimligji jep zgjidhje të drejtë juridike me rast të paraqitjes së ankesës si mjet juridik për mbrojtjen e të drejtave duke mos përcaktuar... (ndërprerje në ton)... dyshkalltësisë nga se nuk mund t'i ankohesh të njëjtit organ që ka marrë vendimin në shkallën e parë.*

*Dhe mendoj se neni 30 nuk ka kuptim si i tillë juridik kur thuhet "zëvendëson çdo ligj që nuk është në përputhje me këtë" dhe ka shumë ligje që nuk janë në përputhje me këtë.*

*Dhe, në fund veçoj një dukuri të kohës së fundit se disa propozimligje më shumë po kanë amendamente se sa nene të propozuara nga propozuesi. Kjo ndërron strukturën juridike tërësisht të propozimligjit dhe ndryshon përmbajtjen e ligjit. Vlerësoj se në raste të këtilla është e arsyeshme të takohet komisioni funksional me propozuesin dhe Komisioni për kornizë kushtetuese e ligjore që rastin ta shqyrtojë.*

*Duke përfunduar, edhe një herë, në emër të Grupit Parlamentar – vlerësoj se ky ligj duhet të shkojë në shqyrtimin e dytë, me plotësime të amendamenteve.*

***KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:***

*Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës.*

***NAIM MALOKU:***

*Ju falemnderit. Zoti kryetar, të nderuar ministra, të nderuar deputetë,*

*Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të AAK të jap vlerësimin që ka ky Grup Parlamentar në lidhje me Projektligjin në fjalë. Mbështes vërejtet e parafolësve të mij dhe, edhe një herë po e përsëris - se Projektligji është shumë i përgjithësuar megjithë faktin se në Projektligj shihet qartë se Ministria përgatitë dhe do të nxjerrë akte të shumta nënligjore, siç janë të cekura në nenin 3 ku thotë "konform rregullave të ADER-it për transportin tokësor, pastaj atë herkurudhor që do t'i përmbahet rregullave të COTIF-it dhe RID-it". Përkundër këtyre, ligji është shumë i përgjithësuar.*

*Më lejoni që t'i cek disa vërejtje, siç janë për nenin 16, ku bëhet fjalë për liçencat. Mbështes zotriun Jagxhillar që foli në emër të Komisionit parlamentar për tarnsport dhe telekomunikacion që liçenca është e rregulluar në Ligjin për transportin rrugor dhe këtu duhet të zbritet kjo liçencë në leje për transportin. Pra, ato ndërmarrje transportuese që i kanë liçencat, të kenë nevojë për leje të posaçme për transportin e mallrave të rrezikshme.*

*Për nenin 19, dhe m'lejoni ta lexoj se si duket fillimi: "Ministria është e autorizuar nëpërmes akteve të veçanta juridike të nxjerrë rregulla mbi transportin e mallrave të rrezikshme duke përfshirë... por duke mos u kufizuar vetëm në...". Dhe disaherë kjo përsëritet: "duke mos u*

*kufizuar vetëm në...". Ligji duhet të jetë decidiv dhe tani mbetet të theksohet se cilat janë ato çështje në të cilat nuk është kufizuar ky nen.*

*Më lejoni t'përmendi edhe nenin 23... i cili ka të bëjë fjalë për kontrollin, pika 3, nën a), b), c), d) - Patundshmëritë, uzinat ekzistuese, objektet e biznesit, dhe mendoj se këto janë të rregulluara në Ligjin për mbrojtjen e mjedisit, Ligjin për mbrojtjen në punë dhe duhet të rregullohen në ligjin për siguri dhe emergjencë civile, e të mos përsëriten këto se nuk janë objekt... Pra uzinat ku prodhohen materiet e rrezikshme dhe ambientet e punës ku prodhohen këto, nuk duhet të jenë objekt i trajtimit në këtë ligj që bën fjalë për transportin e materieve të rrezikshme.*

*Dhe, në fund, duke i dhënë përkrahje në emër të Grupit Parlamentar këtij Projektligji që të shkojë në procedurë të mëtejshme, shfrytëzoj rastin të jap një sygjerim që është i domosdoshëm – Ministria, me Grupin e ekspertëve që kanë bërë hartimin e këtij ligji - domosdoshmërisht duhet të jetë e kyçur edhe në procedurën në proçesin e amendamentimit. Ju falemnderit zoti kryetar.*

***KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:***

*Ju falemnderit shumë. I bëj me dije diskutuesit që, në emër të grupeve parlamentare dhe në emër të komisioneve, koha e diskutimit është 10 minuta, për deputetë është 5 minuta maksimum. Unë do t'ju falënderoja kur t'jeni racional. Fjalën e ka Blerim Baruti, le të bëhet gati Ibush Jonuzi.*

***BLERIM BARUTI:***

*T'falemnderit zoti kryetar. I nderuari kryetar, të nderuar ministra, të nderuar deputetë dhe të pranishëm të tjerë,*

*Më lejoni që t'paraqes disa nga pikëpamjet në debatin rreth këtij Projektligji. Një prej karakteristikave të jetës bashkëkohore është përdorimi i një numri të madh dhe i shumëllojshëm i materialeve. Absolutikisht është e paparamendueshme që të plotësohen të gjitha nevojat pa shkëmbim intensiv. Gjatë këtij shkëmbimi ndeshemi edhe me materie të rrezikshme. Me qëllim të parandalimit të rrezikut dhe shtimit të mbikëqyrjes gjatë transportimit të mallrave të rrezikshme, të cilat me vetitë e tyre të ndryshme paraqesin rrezik në forma të ndryshme për sigurinë e njerëzve dhe të mjedisit, është e domosdoshme që t'i nënshtrohen rregullativës ligjore gjatë tregtimit të tyre në vend dhe me shtetet tjera.*

*Transportimi i mallrave të rrezikshme mund të realizohet nëpërmjet komunikacionit tokësor, qoftë ai hekurudhor apo rrugor, komunikacionit ajror dhe komunikacionit ujor. Në këtë përfshihen edhe klasifikimi i materieve të rrezikshme, mënyra e shenjëzimit apo etiketimit dhe kushtet e transportit të këtyre mallrave. Disa prej marrëveshjeve ndërkombëtare që aktualisht njihen, e që janë të shënuara me shkurtesa që rrjedhin nga fjalët e gjuhës angleze dhe françeze dhe që kanë të bëjnë me transportimin e mallrave të rrezikshme, janë: ADR – Marrëveshja evropiane për trafik rrugor; RID – hekurudhor; COTIF – hekurudhë ndërkombëtare; IATARAR – trafiku ajror dhe marrëveshjet tjera për transport ujor që Kosova nuk mund t'i realizojë, si ADN, IMDG, CODE e të tjera që kanë selitë e tyre në Gjenevë dhe në Londër.*

*Për Projektligjin kam përshtypjen se është i harmonizuar me rregullat ndërkombëtare në mënyrë që transportimi i këtyre mallrave të bëhet edhe në Kosovë në shkëmbim me shtetet tjera në mënyrë që të lehtësohet dhe thjeshtësohet.*

*Projektligjin e ofruar konsideroj se duhet pranuar me qëllim që në fazën amendamentuese të plotësohet, begatohet ashtu që të marrë formën përfundimtare.*

*Fare për fund, më lejoni që të shpreh konsideratën time për ministrin përkatës dhe për përpiluesit e këtij Projektligji. Ju falemnderit për vëmendje dhe mirëkuptim.*

***<u>KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:</u>***

*Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Ibush Jonuzi, le të përgatitet Agim Krasniqi.*

***<u>IBUSH JONUZI:</u>***

*Zoti kryetar, deputetë të rrespektuar dhe ministra,*

*Në kuadër të projektligjeve të shqyrtuara dhe pastaj të miratuara, sot në shqyrtim të parë kemi edhe Projektligjin për transportin e mallrave të rrezikshme që i bashkëngjitet regjistrit të ligjeve të aprovuara nga ky Parlament. Të gjitha ligjet deri tani të aprovuara kanë rëndësinë e veçantë, por ky Projektligj ka të bëjë me transportimin e materieve dhe mallrave të rrezikshme që duhet të mbështetet në dy shtylla kryesore të funksionalitetit të tij: Nën një – sigurinë në transport; dhe nën dy – aplikimin e procedurave të sigurisë në evidentimin, egzaminimin dhe të udhëheqjes së procedurave përkatëse; të inspektimit në punë lidhur me transportin e këtyre mallrave.*

*Me qëllim që ky ligj të ketë një funksionalitet praktik, si përkah zbatimi ashtu edhe nga interpretimi i tij, mendoj se standardizimi i nocioneve do të kontribuonte në këtë drejtim. Them kështu pasi standardizimi i procedurave të kontrollimit dhe inspektimit të këtyre mallrave gjatë transportit të tyre bën ngritjen e shkallës së sigurisë dhe parandalimin e rreziqeve që mund të shkaktohen me rastin e transportimit të këtyre mallrave.*

*Interpretimi i nocioneve, meqë është thënë në Projektligj, po ka disa ndryshime e që mendoj se e begatojnë n enin për të cilin bëhet fjalë, nënkupton p ajisjen për transportimin e materieve të rrezikshme që mund të bartet përmbi platformë, duhet të jetë i punuar nga materiali i fortë që mund të jetë i përshtatshëm për përdorim të shumëhershëm, të jetë i lehtë për transportim, si dhe ngarkim-shkarkim të menjëhershëm në rast nevoje sepse ka të bëjë me transportimin e materieve të rrezikshme.*

*Standardet e sigurisë nënkuptojnë standardet që rregullojnë dizajnin, konstruktin, pajisjen, furnizimin me personel, funksionalitetin e konteinerit, paketimin dhe përcaktimin e standardit të sigurisë lidhur me atë se cilat mjete mund të përdoren për transportimin e materieve të tilla.*

*Dhe, krejt për fund, u debatua edhe prej kolegëve të nderuar se duhet apo nuk duhet t'u jipet licenca për këto raste. Unë mendoj se patjetër duhet t'u jipet licenca për arsye se nuk është e njëjtë sikur të bëhet transportimi i materialit druror, sikur të bëhet transportimi i mjeteve të rrezikshme eksplozive, ndezëse apo materieve tjera. Në parim e mbështes Projektligjin. Ju falemnderit.*

***<u>KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:</u>***

*Ju falemnderit. Fjalën e ka zoti Agim Krasniqi, pastaj le të bëhet gati Muhamet Kelmendi.*

*AGIM KRASNIQI:*

*Ju falemnderit zoti kryetar,*

*Unë nuk desha të flas për rëndësinë e ligjit dhe për nevojën për këtë ligj që i duhet Kosovës, dhe infrastrukturës ligjore në tërësi të Kosovës. Për këtë foli zoti ministër, por desha konkretisht të flas për disa çështje, vërtetë disa vërejtje që kanë të bëjnë me disa nga nenet e këtij Projektligji.*

*Dhe, do të shkoj konkretisht. Në kapitullin i cili përcakton ndalimin e transportit me automjete jo të përshtatshme, fjala është për nenin 12 pika 1, ku thuhet se "nuk lejohet transportimi i mallrave të rrezikshme me mjete të transportit të u dhëtarëve dhe me mjete..." duhet të hiqen fjalët "të tjera jo të përshtatshme" dhe të zëvendësohen me këto fjalë: "që nuk përmbushin standardet e përcak-*
*tuara teknike". Sepse, sqarimi "si mjete jo të përshtatshme" është konfuz dhe nuk sqarohet mirë.*

*Lidhur me kapitullin i cili përcakton përjashtimin nga marrja e liçencës..., fjala është për nenin 18 pika 1, ku thuhet: "Autoritetet e KFOR-it, TMK, Policia e UNMIK-ut, SHPK" do të duhej të gjenin vend edhe "dhe strukturat e veçanta të mbrojtjes civile dhe gatishmërisë emergjente" dhe të vazhdohet siç është tani në nenin e propozuar "përjashtohen nga liçenca kur merren me transportin e mallrave të rrezikshme gjatë përmbushjes së detyrave të tyre". Duke marrë parasysh*
*natyrën e punës që kanë strukturat e caktuara të gatishmërisë emergjente, do të thotë do të vishin në shprehje edhe ato momente emergjente që edhe ato të përjashtohen nga marrja e liçencës.*

*Kapitulli që flet lidhur me autorizimet, e që ka të bëjë me nenin 19 pika 2, është e ngjashme me atë që e thash edhe për nenin 18, ku duhet të futen në mesin e subjekteve që duhet të kenë autorizime ose nuk duhet të kenë autorizime edhe mbrojtja civile dhe gatishmëria emergjente, duke e larguar fjalën që ka të bëjë për zjarrfikësit, pasi që kjo veprimtari është në kuadër të këtij organi.*

*Pastaj, lidhur me nenin 23, pika 1, e që foli edhe deputeti Kelmendi, rreth asaj që transporti i mallrave të rrezikshme kontrollohet nga organet e autorizuara e që mendoj se mungon edhe një fjalë tjetër – që ato organe duhet të dihen cilat janë dhe duhet të dihen kush i autorizon ato organe, dhe mendoj se duhet t'i shtohet fjala "nga Ministria".*

*Me siguri ndoshta për juristët do të ketë vend edhe për ndonjë vërejtje eventuale, që ka të bëjë me gjobat dhe me nenin 27 ku parashihen gjoba të ndryshme.*

*Kapitulli që ka të bëjë me ankesat, neni 28 pika 2 – "Ministria vendosë në lidhje me ankesën brenda afatit 30 ditor". Mendoj se afati prej 30 ditë është shumë i gjatë dhe kisha me propozue që ky afat të zvogëlohet ose të përgjysmohet në 15 ditë.*

*Këto ishin disa nga vërejtjet konkrete dhe mendoj se me procesimin e mëtutjeshëm në komisionet përkatëse do të amendamentohet ligji dhe projekti si i tillë mendoj se duhet të ketë përkrahjen dhe në parim të aprovohet. Ju falemnderit.*

*KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:*

*Ju falemnderit. E ka fjalën deputeti Muhamet Kelmendi, le të bëhet gati Halil Ahmeti.*

*MUHAMET KELMENDI:*

*I nderuar kryetar, zonja dhe zotërinj,*

*Është mirë që kemi marrë këtë Projektligj sot ta shqyrtojmë dhe besoj se në procedurën e mëtejshme do të ketë përmirësime dhe në shqyrtimin e dytë do të aprovohet.*

*Por ajo që është këtu kryesore për mendimin tim është se çka transporton ky ligj, çka transportohet dhe çka rregullohet nëpërmes këtij ligji. Ne themi se duhet të bëjmë transportin e mallrave të rrezikshme, mirëpo ende nuk e dijmë se çka është malli i rrezikshëm. Shtrohet pyetja: përveç atyre të cilët e njohin çështjen e mallrave të rrezikshme, sepse edhe këtu në Kuvend kemi deputetë të cilët kanë profesionalzëm të tillë, kemi farmaceutistë, kemi kimistë, e tjerë. Kush janë tjerat organe të cilat e njohin se çka është malli i rrezikshëm? Dhe në bazë të ç'kahit pastaj organet e ndjekjes në rrugë mund të gjobojnë dikë i cili transporton një mall e nuk e ka një vendim ose një ligj në bazë të të cilit do të konstatojë se a ka të bëjë me një mall të rrezikshëm apo jo. Dhe, së dyti, transporti i mallrave të rrezikshëm bëhet prej një vendi në një vend tjetër. Ku dërgohet ai mall? Në çfarë deponie, apo në çfarë vendi të caktuar? Pra kemi të bëjmë me një vistër të tërë çështjesh për të cilat unë mendoj se duhet të rregulloheshin njëherësh, nëpërmes të cilave do të rregullohej në radhë të parë se çka është malli i rrezikshëm dhe si konstatohet ai. Së dyti – transporti i mallrave të tillë të rrezikshëm, dhe së treti – vendi se ku dërgohet. Sepse malli i rrezikshëm merret në një vend të caktuar dhe dërgohet në një vend tjetër, Pra është një vend ku merret, është edhe një vend ku dërgohet dhe natyrisht duhet të dijmë pastaj se me çfarë malli kemi të bëjmë.*

*Këto çështje janë jashtëzakonisht delikate dhe mendoj se është e domosdoshme që të ecet në këtë drejtim: të konstatohet në radhë të parë malli i rrezikshëm, pastaj vjen faza e dytë - transporti dhe faza e tretë është - vendi ku dedikohet që të transportohet ai mall.*

*Në qoftë se këto çështje nuk rregullohen në mënyrë të njëhershme dhe përnjëherësh, atëherë natyrisht ka mungesa të mëdha dhe ka shumë vështirësi, dhe sidomos ministri për transport dhe telekomunikacion duhet të dijë se është shumë vështirë kjo të gjejë pastaj zbatim adekuat në jetën praktike të Kosovës. Ju falemnderit.*

*KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:*

*Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Halil Ahmeti, le të përgatitet Sylejman Çerkezi.*

*HALIL AHMETI:*

*I nderuar kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar ministra,*

*Projektligji, të cilin e shqyrtojmë sot, është me rëndësi të veçantë sepse me të synohet të parandalohet rreziku gjatë transportit të mallrave të rrezikshme, vetëndezëse, shpërthyese, helmuese, radioaktive e tjera që mund të paraqesin rrezik për jetën e njerëzve dhe të mirave të tjera materiale dhe mjedisit në tërësi me përmasa të vogla apo përmasa të mëdha.*

*Unë në parim përkrah Projektligjin, por kam disa vërejtje të cilat komisioni funksional do duhej t'i shqyrtojë gjatë amendamentimit.*

*Vërejtjet e mia janë me sa vijon: në nenin 11, 13, 14, 23, 24, 26 dhe 27, për të cilat nene zbraztësitë dhe paqartësitë do të eliminohen në të ardhmen, e të cilat edhe do t'i përmendi, kryekëput për çështje kryesore.*

*Për shembull, nuk është qartësuar kush i bën shqyrtimet e cisternave dhe ngarkesave tjera dhe kush bën përcaktimin e shkallës së rrezikshmërisë; kush bën kontrollimin e dokumentacionit për transport qoftë brenda Kosovës apo ndërkombëtar; kush jep lejen; kush bën përcjelljen e transportit dhe mbanë përgjegjësinë rreth masave të sigurisë gjatë përcjelljes? Ne e dijmë mirë që këto çështje sot prekin në kompetencat e rezervuara, të cilat çështje do të binin si kompetenca faktikisht mbi ministrinë e rendit – në sektorin e preventivës, mbrojtjes nga zjarri dhe shpërthimit, të cilën ministri nuk e kemi sot, por do ta kemi nesër. Ju falemnderit.*

***KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:***

*Ju falemnderit. E ka fjalën edhe Sabit Rrustemi.*

***SABIT RRUSTEMI:***

*Ju falemnderit. Duke ju përshëndetur zoti kryetar nga rreshtat e fundit juve, ministrat dhe deputetët, parimisht e mbështes këtë ligj dhe do të përpiqem t'mos i përsëris disa nga vërejtjet që i thanë tjerët , që i kisha edhe unë përafërsisht.*

*Konkretisht mendoj se neni 20, ku është çështja e edukimit, duhet të fshihet, sepse kjo më tepër është çështje e detyrave strategjike të Ministrisë se sa e ligjit.*

*Çështja ku flitet për bashkëpunimin me ministritë tjera, mendoj se me ministritë tjera bashkërendohen punët, e nuk bashkëpunohen se ato janë një organ i përbashkët.*

*Dhe, te çështjet e gjobave – neni 27. Mendoj se duhet të specifikohen denimet sipas neneve, e jo të shkohet në tërësi në bazë të ligjit. Dhe krahas rrezikshmërisë që paraqesin këto mallra, janë shumë të vogla dënimet, sidomos për personat juridik. Për shembull, thuhet se "personat juridik që nuk e zbatojnë ligjin do të dënohen prej 500 deri në 5.000 euro". Mendoj se janë dënime të vogla dhe këto duhet të sanksionohen në bazë të neneve që janë brenda këtij ligji. Ju falemnderit.*

***KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:***

*Ju falemnderit shumë. Meqë nuk ka tjerë të paraqitur, ju ftoj që t'i japim përkrahje Projektligjit, sepse asnjë grup parlamentar nuk e ka kontestuar në parim.*

*Kush është për aprovim në parim të Projektligjit? Ju falemnderit shumë.*

*A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.*

*A abstenon kush? Nuk ka as abstenime.*

*75 deputetë janë të pranishëm, prandaj komisionet që i referohen të punojnë janë: Komisioni funksional, ai për Transport dhe komunikacion, pastaj Komisioni për gjyqësi, legjislacion e kornizë kushtetuese dhe Komisioni për buxhet.*

---

*Votimi – Glasanje – Voted:*
- *Për – Za – For ........................Shumica – Većina – Majority...........*
- *Kundër – Protiv – Against .........................00..................*
- *Abstenime – Uzdržani – Abstaned.............00..................*

---

*Pika e tretë e rendit të ditës. Ministri ose Ministria sponsore e ligjit, apo Qeveria nuk është e pranishme. Dje ka qenë ministri, dhe është lajmëruar. Sot nuk është, prandaj edhe pika 3 e rendit të ditës nuk mund të shqyrtohet, sepse deri në këtë moment nuk po e shoh në sallë sponsorin e ligjit.*

*Urdhëroni, ndoshta jo si sponsor i ligjit, por vetëm për diskutim? Urdhëro Tomë.*

*TOMË HAJDARAJ:*

*Ju falemnderit zoti kryetar. Me të vërtetë është për t'u habitur që nuk merr pjesë anëtari i Qeverisë, i cili mbulon digasterin e bujqësisë, por mos ta harrojmë faktin se ky ligj veç është nënshkruar dhe përfunduar në Qeveri prej muajit shtator të vitit të kaluar. E nëse ne mbesim pre e funksionit të ministrit, unë mendoj se kishim për të gabuar sot dhe nuk ka kurgjë të keqe që ky ligj sot me të vërtetë në parim të miratohet, duke patur parasysh faktin se është afati optimal që i njëjti të hyjë në implementim gjatë kësaj pranvere.*

*Ju lutem, nuk është edhe pengesë juridike mësa duket...*

*KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:*

*Jo, jo. Do të kërkohet nga kryeministri që të gjejë zgjidhje, por ne nuk mund të votojmë për diçka që nuk e dëgjojmë fjalën hyrëse dhe mos ta thejmë rregullin elementar. Do të thotë, duhet të kërkohet nga Qeveria gjithmonë të ketë zëvendësim.*

*TOMË HAJDARAJ:*

*Zoti kryetar, edhe deri më tash funksioni i njeriut që udhëheqë digasterin e bujqësisë nuk ka kryer asnjë punë as në ligje as në projekte. Duhet ta shfrytëzoni autoritetin tuaj te kryeministri dhe Qeveria të vendoset që të vjen përfaqësuesi i stafit civil, gjegjësisht sekretari permanent i cili me përkushtim ka kryer punët deri më tash, sepse në saje të punës së tij dhe të stafit të cilin e drejton ne kemi miratuar më së shumti projektligje dhe ligje në këtë Parlament nga sfera e bujqësisë. E nëse ne varemi dhe humbim në kohë, kemi me humbë edhe në kualitet, edhe në aplikueshmëri. Kemi me humbur, siç thash edhe në kualitet dhe pastaj po themi: – jo hyn materiali i dyshimt, jo ushqimi i dashimt...! Kjo është ajo që ne na lidhë dhe ndërlidhë. Dhashtë zoti që t'mos përsëritet në zgjedhjet e ardhshme kjo çështje. Ju falemnderit.*

*KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:*

*Ju falemnderit. Megjithatë, kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për barazi gjinore.*

*Më lejoni t'i them disa konstatime hyrëse.*

*Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë më 23 tetor 2003.*

*Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit ia kanë bërë rekomandimet si vijon:*

- *Komisioni për gjyqësi, legjislacion dhe kornizë kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji ka bazueshmërinë në Kornizën kushtetuese;*
- *Komisioni për buxhet ka vlerësuar se Projektligji nuk përmban implikime financiare dhe buxhetore, por propozon një amendament nga fusha e përgjegjësive të veta;*

- *Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve ka vlerësuar se me këtë ligj nuk cenohen të drejtat dhe interesat e komuniteteve; dhe*
- *Komisioni për barazi gjinore, në cilësinë e propozuesit të Projektligjit, Kuvendit i ka paraqitur raport dhe rekomandime me amendamente, që do të procedohen gjatë votimit.*

*S'e di pse këtu ma kanë shkruar prap radhën e diskutimeve: propozuesi i Projektligjit; kryetari i Komisionit funksional; kryetarët e komisioneve kryesore; kryetarët e grupeve parlamentare.*

*Ju lutem, vetëm në qoftë se është e domosdoshme dhe ka nevojë substanciale që në këtë radhë dikush të paraqitet, e nëse jo – të kalojmë në aprovimin e amendamenteve. Si do ta vlerësoni ju? Unë e lexova, dhe sygjerimet e Sekretarisë janë këto.*

*Pasi që nuk ka të interesuar për diskutim, atëherë kalojmë në miratimin e amendamenteve.*

*Amendamenti 1, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? 1 votë kundër.*
*A ka abstenime? 1 abstenim.*
*Prandaj, konsideroj se amendamenti 1 është aprovuar.*

*Amendamenti 2, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.*
*A abstenon ndokush? 1 abstenim.*
*Kalon amendamenti 2.*

*Amendamenti 3, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka kush kundër? Nuk ka votë kundër?*
*A abstenon kush? 1 abstenim.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 4, Komisioni funksional.*
*Kush është për?*

*Po, urdhëroni...*

***SABRI HAMITI:***

*Ky amendamenti 4 është një send i çuditshëm! Unë edhe në atë variantin e parë kur e kam lexue e di që e kam nënvizue, prap këtu e kemë. Problemi është për një formulim që mua më duket i papërshtatshëm që të hyjë në ligj. Njerëzit që e kanë shkruar këtë ligj m'kanë thënë që janë munduar ta qesin një formulim tjetër dhe s'e kanë gjetë.*

*Neni thotë: "Të gjitha institucionet e Kosovës janë të obliguara të përfillin barazinë gjinore në gjuhë në të gjitha dokumentet zyrtare". Mua nuk më pëlqen ky. Më në fund - ma kanë shpjegue çka do të thotë kjo, se s'e kam dijt. Barazia gjinore në gjuhë?! Mos me i thënë kryetar - asaj që është grue, por kryetare për shembull, ose studentit - student. Po mua më duket që s'ka nevojë, në esencë për ne zbatohet norma gjuhësore dhe normalisht që atje ku ka gjini si shqipja që i ka – i thuhet mashkullore-femnore. Si turqishtja, që më duket s'i ka, atëherë është problem. Te këta mundet "kjo djal" me i thënë, por është problem i gjuhëve kjo.*

*Kështu që, po them, ndoshta është krejt i padobishëm ky. Nuk e dij!? Kaq kisha unë.*

*KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:*

*Mendoj se kjo që thotë profesori është kompetent dhe nuk kemi nevojë ta votojmë.*

*Por, megjithatë – kush është për amendamentin 4 në formën e Komisionit funksional. Këtë e kam obligim me ju pyet? Ju falemnderit.*

*Nuk kalon.*
*Urdhëro, Hydajet.*

*HYDAJET HYSENI:*

*Desha vetëm një sqarim. Ne jemi vërtetë në vështirësi për të rrespektuar procedurën dhe për të korrigjuar në këto çështje. Por mendoj se të dy variantet, edhe varianti fillestar që kërkon të jenë të detyruara dha varianti i propozuar me amendamente të obliguara – në të vërtetë e kanë të njëjtin difekt. Kërkojnë, do të thotë, një normë që është në kundërshtim me normën e gjuhës shqipe, prandaj do t'ishte mirë që propozuesi, në këtë rast deputeti Hamiti, ta formulojë propozimin, do të thotë që të shlyhet ky paragraf tërësisht sepse vetëm në atë mënyrë mund të jemi në përputhje me normën, apo jo.*

*KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:*

*Unë kam një sqarim. Thatë: të shlyhet krejt paragrafi? Prandaj, unë mendoj se aprovohet si i panevojshëm, dhe po shoh se edhe sponsori i ligjit pajtohet dhe le të fshihet ai paragraf.*

*Kalojmë në amendamentin 5. Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit shumë.*
*A ka votë kundër? 2 vota kundër.*
*A ka abstenime? Nuk ka abstenime.*
*Kalon amendamenti 5.*

*Amendamenti 6, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? Nuk ka kundër.*
*A ka abstenime? 1 abstenim.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 7, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.*
*A abstenon kush? 1 abstenim.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 8, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? 1 votë kundër.*
*A ka abstenime? Nuk ka abstenime.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 9, Komisioni funksional.*
*Nuk ka vërejtje.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.*
*A abstenon kush? Nuk ka as abstenime.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 10, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka kush kundër? 1 kundër.*
*A abstenon kush? Nuk ka abstenime.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 11, Komisioni funksional.*
*Nuk ka vërejtje.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? Nuk ka kundër.*
*A abstenon kush? Nuk ka as abstenime.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 12, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka kush kundër? Nuk ka kundër.*
*A abstenon kush? Nuk abstenon.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 13, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? 1 kundër.*
*A ka abstenime? Nuk ka abstenime.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 14, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? Nuk ka kundër.*
*A ka abstenime? Nuk ka as abstenime.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 15, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? Nuk ka kundër.*
*A abstenon kush? Nuk abstenon.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 16, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? Nuk ka.*
*A abstenon kush? Nuk abstenon.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 17, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka kush kundër? 1 votë kundër.*

*A ka abstenime? Nuk ka.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 18, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka kush kundër? 1 kundër.*
*A ka abstenime? Nuk ka.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 19, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka kush kundër? Nuk ka.*
*A abstenon kush? Nuk abstenon.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 20...*
*Po, urdhëroni të merrni fjalën.*

***HYDAJET HYSENI:***

*Ndoshta është lëshim i natyrës më shumë teknike-redaktoriale, por mendoj që do të ishte mirë megjithatë të korrigjohet. Kështu siç është, fjalia mbetet e pakuptimtë. Prandaj, pjesës së propozuar të fjalisë për t'u fshirë "kanë për detyrë" duhet t'i shtohet edhe "që" në mënyrë që fjalia të ketë kuptim. Përndryshe s'ka kuptim dhe s'funksionon. Ju falemnderit.*

***KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:***

*Unë mendoj se mund të aprovohet kjo.*
*Kush është për, me këtë sygjerim? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? Nuk ka.*
*A ka abstenime? Nuk ka.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 21, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? Nuk ka.*
*A ka abstenime? 1 abstenim.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 22...*

*Urdhëro Hydajet.*

***HYDAJET HYSENI:***

*Vërejtjet që, për mendimin tim, është e bazuar, është e njëjtë edhe në nenet pasuese. Do të thotë është fjala në tekst në 13.6, por e njëjta gjë është edhe në nenin 13.8 dhe 13.9. Prandaj, vetëm do të kërkoja që të shtohen edhe këto nene dhe atëherë të amendamentohen, do të thotë bashkërisht, sepse është e njëjta përmbajtje dhe i njëjti formulim krejtësisht.*

***KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:***

*Çka mendon propozuesi i ligjit dhe Komisioni funksional?*

***MELIHATE TËRMKOLLI:***

*Mendoj që janë çështje teknike, prandaj nuk ka asnjë arsye që të mos pranohen.*

***KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:***

*Ju falemnderit.*
*Kush është për këtë amendament, me propozimet e zotit Hyseni? Ju falemnderit.*
*Kush është kundër? 2 vota kundër.*
*A ka abstenime? 1 abstenim.*
*Kalon amendamenti siç u propozua.*

*Amendamenti 23, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka kush kundër? 1 votë kundër.*
*A ka abstenime? Nuk ka.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 24, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? Nuk ka.*
*A ka abstenime? Nuk ka.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 25, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka kush kundër? Nuk ka.*
*A abstenon kush? 1 abstenim.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 26, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka kush kundër? Nuk ka.*
*A ka abstenime? Nuk ka.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 27, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? Nuk ka.*
*A abstenon kush? Nuk abstenon.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 28, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka kush kundër? Nuk ka.*
*A abstenon kush? 1 abstenim.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 29, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka kush kundër? 2 vota kundër.*
*A ka abstenime? Nuk ka abstenime.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 30, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? Nuk ka.*
*A ka abstenime? Nuk ka.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 31, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka kush kundër? Nuk ka.*
*A abstenon ndokush? Nuk abstenon askush.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 32, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka kush kundër? 2 kundër.*
*A abstenon kush? Nuk abstenon.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 33, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka kush kundër? 3 vota kundër.*
*A abstenon kush? Nuk abstenon.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 34, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? 3 vota kundër.*
*A ka abstenime? Nuk ka.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 35, Komisioni i buxhetit.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? Nuk ka kundër.*
*A abstenon kush? Jo.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 36, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? Nuk ka.*
*A abstenon kush? 1 abstenim.*
*Kalon amendamenti.*

*Amendamenti 37, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër?*
*A abstenon kush?*
*2 abstenime, nuk ka kundër – kalon amendamenti.*

*Dhe, amendamenti 38 – i fundit, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? 2 vota kundër.*
*A abstenon kush? 1 abstenim.*
*Kalon amendamenti.*

*Dhe, në fund, më lejoni t'ju pyes: a aprovohet Ligji i amendamentaur siç kemi proceduar?*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? 1 kundër.*
*A abstenon kush? Nuk ka abstenime.*

*72 deputetë të pranishëm në sallë, prandaj konsideroj se është aprovuar Ligji.*

*(Duartrokitje)*

---

*Votimi – Glasanje – Voted:*
- *Për – Za – For ........................Shumica – Vecina – Majority...........*
- *Kundër – Protiv – Against ........................01..................*
- *Abstenime – Uzdržani – Abstaned.............00..................*

---

*Ju lutem, unë dua t'ju propozoj diçka. Unë ndiej se ka lodhje te ne dhe duhet ta japim një pauzë, gjatë së cilës do të bëhet edhe pauza e drekës ose e mëngjesit, të them. Prandaj a ka kush propozim për zgjatjen e pauzës – që të zgjatë një orë apo dy. Atëherë do të bëjmë pauzë njëorëshe e gjysmë. Ju falemnderit, në orën 13 vazhdojmë seancën.*

*(Vijoi pauza)*

*(Pas pauzës, Seanca vazhdoi punën)*

*Në vazhdim punën e Seancës e kryesoi bashkëkryesuesi Hydajet Hyseni.*

*KRYESUESI HYDAJET HYSENI:*

*Deputetë të nderuar, po vazhdojmë punën.*

*Materialet i keni marrë me kohë. Komisionet kanë shqyrtuar Projektligjin dhe kanë dhënë vërejtjet e tyre.*

*Nëse eventualisht dikush ka diçka në fillim, ndonjë vërejtje të natyrës parimore e tjera, sipas praktikës së përgjithshme, mund t'i paraqitni dhe urdhëroni.*

*E ka fjalën Arsim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.*

*ARSIM BAJRAMI:*

*Të falemnderit zoti kryesues. Këtë radhë do të flas në emër të Komisionit për çështje legjislative dhe kushtetuese që ka qenë njëkohësisht edhe Komision funksional dhe ka prezentuar këto amendamente. Mund të them se ne në Komision kemi pasë një dilemë me rastin e paraqitjes së këtyre amendamenteve. Ajo dilemë ka konsistue në faktin se ia vlenë apo nuk ia vlenë të bëjmë*

*amendamente në një ligj, i cili në koncept nuk ka qenë i mirë. Megjithatë, ligji ka kaluar në leximin e parë dhe pasi ka kaluar në leximin e parë ne nuk kemi mund me rekomandue që ligji të rikthehet dhe të shkruhet në tërësi. Për shkakun se shumë formulime që përmbanë ky ligj janë formulime atipike, më tepër formulime politike dhe nuk kanë një kompozicion logjik çfarë do duhej t'i ketë ligji.*

*Gjithashtu, edhe në leximin e parë, por edhe në Komision ka qenë e diskutueshme se ka apo s'ka nevojë Kosova të ketë një ligj kundër diskriminimit kur dihet fakti se shumica e ligjeve, apo të gjitha ligjet që po miraton ky Kuvend po kanë dispozita kundër diskriminit. Por, meqenëse Qeveria si sponsoruese e ka pa të nevojshme, atëherë ne jemi munduar që me këto amendamente, në fakt ta përmirësojmë aq sa mund të përmirësohet me amendamente ky ligj.*

*Amendamentet kryesisht konsistojnë në faktin që ligji të marrë më tepër një koncept civil e qytetar, më pak një koncept etnik dhe siç po e shihni ne kemi hjekë nga ligji termat, siç është: populli, pajtimi i popujve, dialogu shoqëror. Pra, disa terma që janë pjesë e një terminologjie të sistemit të kaluar dhe që nuk përkojnë me doktrinat e reja juridike dhe kemi propozuar gjithsej 8 amendamente të cilat në fakt tentojnë ta bëjnë të mirë një ligj, i cili në koncept nuk është i mirë.*

*Megjithatë, ne propozojmë që Kuvendi t'i miratojë këto amendamente dhe kërkojmë nga Qeveria që me rastin e sponsorimit dhe hartimit të ligjeve të jetë shumë më e kujdesshme, shumë më e kujdesshme se si po shkruhen ligjet për shkak se, siç dihet, këto ligje duhet të përmbajnë standarde evropiane, pra një parim të cilin e synojmë të gjithë ne.*

***KRYESUESI HYDAJET HYSENI:***

*Me sa shoh, nuk ka ndonjë kërkesë tjetër për ta marrë fjalën. Për informimin tuaj, të shtoj se Komisioni për çështje gjuqësore, legjislative dhe kornizë kushtetuese ka vlerësuar, siç u tha edhe një herë se Projektligji ka bazueshmëri juridike.*

*Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve ka vlerësuar se Projektligji kundër diskriminimit dhe amendamentet e propozuara me këtë rast nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.*

*Ndërkaq, Komisioni për buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit kundër diskriminimit dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime të papranueshme buxhetore.*

*Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimet e Komisionit për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese si Komision që është përcaktaur me këtë rast të jetë Komision funksional dhe raportues.*

*Prandaj, me pëlqimin tuaj, shkojmë në shqyrtimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës që i keni, besoj të gjithë.*

*Amendamentet janë të gjitha të Komisionit funksional, prandaj edhe nuk ka nevojë që këtë ta përsërisim me radhë si propozues.*

*Amendamenti 1.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*Kundër? Nuk ka.*

*Abstenime? Nuk ka.*
*Konstatoj se aprovohet amendamenti 1.*

*Amendamenti 2, po ashtu i Komisionit funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*Kundër? 1.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet amendamenti me shumicë votash.*

*Amendamenti 3.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Konstatoj se edhe amendamenti 3 aprovohet.*

*Amendamenti 4.*
*Kush është për?*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet amendamenti.*

*Amendamenti 5, Komisioni funksional.*
*Kush është për?*
*A ka kundër? 1.*
*Abstenime? 1.*
*Konstatoj se aprovohet.*

*Amendamenti 6, Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A voton kush kundër? Jo.*
*A ka abstenime? 1.*
*Konstatoj se amendamenti aprovohet.*

*Amendamenti 7.*
*Kush është për?*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime?*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 8.*
*Kush është për?*
*A ka votë kundër? Jo.*
*A ka abstenime? Jo.*
*Konstatoj se amendamenti aprovohet.*

*Me kaq përfundon edhe shqyrtimi i amendamenteve të propozuara nga Komisioni funksional.*

*Në sallë kemi 70 deputetë të pranishëm, do të thotë mund të votojmë.*

*Prandaj, ftoj Kuvendin që të deklarohet për aprovimin si tërësi të Ligjit kundër diskriminimit në Kosovë.*

*Kush është për? Ju falemnderit. Është shumica dërrmuese.*
*A ka kush kundër? Nuk ka asnjë votë kundër.*
*A abstenon kush? Nuk ka as abstenime.*

*Konstatojmë se Kuvendi aprovoi njëzërit Projektligjin, tani Ligjin kundër diskriminimit në Kosovë.*

*(Duartrokitje)*

---

*Votimi – Glasanje – Voted:*

- *Për – Za – For ..........................Shumica – Vecina – Majority...........*
- *Kundër – Protiv – Against ........................00..................*
- *Abstenime – Uzdržani – Abstaned.............00..................*

---

*Në radhë, kolegë deputetë, kemi edhe dy projektligje tjera: Projektligjin për shëndetësi dhe Projektligjin për bashkëpunim me Tribunalin Penal të Hagës.*

*Sipas radhës, për shqyrtimin e ligjeve do t'ishte mirë t'ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit e Qeverisë, respektivisht sponsorët e ligjit. Pra, përsërish edhe një herë atë që është konstatuar edhe më parë se në shqyrtimin e ligjeve duhet të marrë pjesë edhe Qeveria, do të thotë sponsorizuesit dhe ata duhet edhe t'i japin qëndrimet e tyre.*

*Megjithatë, pasi për këtë ka një harmonizim midis sponsorizuesit dhe Komisionit, atëherë propozojmë që të shkojmë me radhë, natyrisht nëse nuk ka ndonjë vërejtje paraprake nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare.*

*Urdhëroni zoti Hamiti. Fjalën e ka Sabri Hamiti.*

*SABRI HAMITI:*

*Unë do të pritsha që rreth këtij ligji të flasë dikush nga Komisioni për arsye se unë e dij që kanë punue gjatë e shumë dhe kanë qenë shumë unik, sa unë i kam përcjell, rreth punës së admendamentimit të këtij ligji. Nën një.*

*Nën dy. Sepse ka kaq shumë amendamente, janë 100 dhe unë nuk dij a ka mundësi... Unë e dij që teknikisht ka mundësi, por ka mundësi edhe institucionale që të mos votohet secilën herë për secilin nen, nëse ka mundësi, por në pako – eventualisht. Kjo për shkak se është mirë, po them edhe një herë, që të referojnë këta të komisionit dhe vetëm nëse ka ndokush vërejtje paraprakisht përnjëmend. Ju falemnderit.*

*KRYESUESI HYDAJET HYSENI.*

*Të falemnderit zoti Hamiti. Fjalën e ka zonja Nafije Gash, në emër të Komisionit funksional – Komisionit për shëndetësi. Urdhëroni zonja Gash.*

*NAFIJE GAŞ:*

*Ju falemnderit. Të nderuar deputetë,*

*Në shqyrtimin e sotëm të dytë të ligjit për shëndetësinë e Kosovës, do të keni para vetes shumë amendamente, gati 100, që nuk e ndryshojnë në mënyrë thelbësore ligjin e propozuar nga ministria përkatëse por e pasurojnë atë dhe qartësojnë më shumë dhe në disa pjesë e bëjnë më praktik dhe më funksional.*

*Ne kemi pasur edhe një dëgjim publik, dhe nga njerëz të profesionit kemi patur vërejtje e sygjerime shumë të mira, të cilat janë futur në kuadër të amendamenteve që i kemi para vetes.*

*Deputetë të nderuar, pra unë mendoj se me këtë ligj, që do ta miratojmë sot e përmbushim një obligim tonin para zgjedhësve, votën e të cilëve e përfaqësojmë, si dhe kemi kënaqësinë se e rregullojmë shumë më mirë një lëmi aq të rëndësishm edhe aq të dobishme për të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim.*

*Gjithashtu, jam i të njëjtit mendim, sikurse zoti Sabri Hamiti, që mund të votohet në pako, sepse përveq që kemi një sqarim në amendamentin 59 si Komision funksional e që nuk është përkrahur nga Komisioni për interesa dhe të drejta të komuniteteve dhe si Komision kemi pasur për atë që është bërë një lëshim dhe kemi një përmirësim, apo një propozim të ri që do ta them tani.*

*Është fjala për nenin 54, që të shtohet një pikë e re - 54.2 me këtë tekst: "Punëtori shëndetësor, i cili e ndihmon personin në situatë", në vend të "situatë" të jetë "në vendin e fatkeqësisë, nuk mund të ndiqet në mënyrë gjyqësore për shërbimin e mangët profesional" dhe të shtohet "për shkak të mungesës së mjeteve të nevojshme për ndihmë". Pra, kjo më mirë e kjartëson këtë amendament.*

***KRYESUESI HYDAJET HYSENI:***

*(Ndërprerje e shkurtër në ton)*

*...Sipas Rregullores së punës ne jemi të obliguar që amendamentet t'i shqyrtojmë veç e veç, me përjashtim kur ato janë - do të thotë - të një natyre..., dhe ne kemi një sërë amendamentesh që janë me të vërtetë nënamendamente të përmbledhura në një amendament. Për të mos lejuar formalizim të procedurës edhe ashtu deridiku shumë të përcipt të shqyrtimit, unë do të lusja për durimin tuaj dhe megjithatë t'i kalojmë një nga një amendamentet.*

*Paraprakisht dëshiroj, për njoftimin tuaj, të theksoj se Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji në fjalë ka bazueshmëri juridike në Kornizën kushtetuese.*

*Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve ka vlerësuar se Projektligji nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve, me përjashtim të një amendamenti që propozon ky Komision për t'u fshirë nga amendamentet e propozuara, është fjala për amendamentin 59.*

*Komisioni për buxhet ka vlerësuar se ky Projektligj nuk ka implikime të papranueshme buxhetore.*

*Ndërkaq, Komisioni për shëndetësi na ka ofruar vistrën e gjatë të amendamenteve që i kemi përpara.*

*Propozoj të shkojmë me radhë dhe mundësisht t' përpiqemi të jemi sa më racional.*

*Amendamenti 1.*
*Kush është për? Është shumica.*
*A ka kush kundër? Jo.*
*A abstenon kush? Jo.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 2.*
*Për? Shumica. Ju falemnderit.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? 1.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 3. Ka disa nënamendamente. Nëse pajtoheni i aprovojmë të gjitha përnjëherë.*
*Kush është për? Është shumica. Ju falemnderit.*
*A ka kush kundër? Nuk ka.*
*A abstenon kush? 1.*
*Konstatoj se amendamenti aprovohet.*

*Amendamenti 4.*
*Kush është për? Është shumica.*
*Kush është kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? 1. Ju falemnderit.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 5.*
*Për? Falemnderit.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet njëzërit.*

*Amendamenti 6.*
*Kush është për?*

*__(Reagim – nuk kyçet mikrofoni)__*

*__KRYESUESI HYDAJET HYSENI:__*

*Po megjithatë mund të ketë edhe amendamente në të cilat ka mendime të ndryshme. Ju lutem megjithatë, edhe për hirë të rregullës, le të shkojmë me radhë.*

*Kush është kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Njëzërit aprovohet.*

*Amendamenti 7.*
*Kush është për? Shumica. Ju falemnderit.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet njëzërit.*

*Amendamenti 8.*
*Kush është për? Falemnderit.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet njëzërit.*

*Amendamenti 9.*
*Për? Falemnderit.*
*Kundër? Nuk ka.*

*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 10.*
*Për? Falemnderit.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 11.*
*Për? Falemnderit.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 12.*
*Për? Të gjithë. Ju falemnderit.*
*Kundër?*
*Abstenime. Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 13.*
*Për? Pothuaj, të gjithë.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 14.*
*Për? Falemnderit.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 15.*
*Për? Ju falemnderit.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 16.*
*Për? Ju falemnderit.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 17.*
*Për? Ju falemnderit.*
*Kundër? Nuk ka.,*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 18.*
*Për? Falemnderit.*

*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 19.*
*Kush është për amendamentin 19? Ju falemnderit.*
*Kundër? S'ka.*
*Abstenime? S'ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 20.*
*Për? Të gjithë.*
*Kundër? S'ka.*
*Abstenime? S'ka. Ju falemnderit.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 21.*
*Për? Falemnderit.*
*Kundër? S'ka.*
*Abstenime? S'ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 22.*
*Për? Falemnderit.*
*Kundër? S'ka.*
*Abstenime? S'ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 23.*
*Për?*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime. Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 24.*
*Për? Shumica. Ju falemnderit.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*

*Tash e marr me mend se sa është pak si punë e lodhshme të votohen të gjitha këto amendamente, por merreni me mend kohën – derisa i kanë shkruar të gjitha ato dhe i kanë shqyrtuar, prandaj duhet të kemi edhe ne pak durim e t'i shqyrtojmë.*

*Amendamenti 25.*
*Për?*
*Kundër?*
*Abstenime? S'ka.*
*Me shumicë votash, aprovohet.*

*Amendamenti 26.*
*Për? Falemnderit.*
*Kundër? S'ka.*

*Abstenime? S'ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 27.*
*Për? Shumica: Falemnderit.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 28.*
*Për?*
*Kundër?*
*Abstenime? Falemnderit, edhe për vërejtjen.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 29.*
*Kush është për?*
*Kundër?*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 30.*
*Për?*
*Kundër?*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Me shumicë votash, aprovohet.*

*Amendamenti 31.*
*Për?*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet njëzërit.*

*Amendamenti 32.*
*Për?*
*Kundër?*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Njëzërit aprovohet.*

*Meqë vërtet është evidente se të gjitha amendamentet kështu do të shkojnë, unë do të pyes deputetët – a kanë vërejtje specifike në ndonjërin nga amendamentet e paraqitura, do të thotë që ndonjëri do të bënte vërejtje... që të mund ta rrespektojmë atë që ishte kërkesë edhe e shumicës së deputetëve, dhe tani po bëhet rutinë.*

*A pajtohet përbëria e Kuvendit, që të votohen amendamentet vazhduese am bllok, sipas rekomandimeve të Komisionit...?*

*(Ndërhyrje – pa kyçje të mikrofonit)*

*Dakord. Meqë do t'mund të ketë vërejtje në ndonjë nga amendamentet në vijim, atëherë vazhdojmë me procedurën e paracaktuar. Ju falemnderit për mirëkuptimin.*

*Amendamenti 33.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*Kush është kundër? 1.*
*A abstenon kush? Jo.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 34.*
*Kush është për? Falemnderit.*
*A ka kush kundër? Jo.*
*A abstenon kush? Jo.*
*Aprovohet.*

*Lus deputetët që për amendamentet në të cilat mund të kenë vërejtje, le ta kërkojnë fjalën në fillim, do të thotë me përmendjen e amendamentit përkatës.*

*Amendamenti 35.*
*Kush është për? Falemnderit.*
*A ka kush kundër? Nuk ka.*
*A abstenon kush? Jo.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 36.*
*Kush është për? Ju falemnderit.*
*A ka kush kundër? Jo.*
*A abstenon kush? Jo.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 37.*
*Kush është për? Falemnderit.*
*A ka kush kundër? Nuk ka.*
*A abstenon kush? Jo.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 38.*
*Për? Shumica. Ju falemnderit.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 39.*
*Për?*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 40.*
*Për?*
*Kundër? 2.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 41.*
*Për?*

*Urdhëroni, ju lutem. E ka fjalën deputeti Sabit Rrustemi.*

*SABIT RRUSTEMI:*

*Jo, vetëm do të doja sqarim. Çka është "shëndeti riprodhues", sepse më është e paqart. Ju lutem, po e lexoj kështu tekstualisht: "Përparimi i shëndetit riprodhues". Lus Komisionin, ose kryetarin e Komisionit të japë sqarime.*

*KRYESUESI HYDAJET HYSENI:*

*Pyetje jo vetëm pak e vonë, por edhe krejt e pazakonshme, por për ta pasuruar edhe praktikën tonë, lusim Komisionin që këtë ta sqarojë. E ka fjalën deputetja Hulaj.*

*NURIJE HULAJ:*

*Duke ditur rëndësinë e mbrojtjes shëndetësore të nënës dhe fëmiut, posaçërisht këtu në amendamentin konkret, ku shkruhet "shëndeti riprodhues" dhe flitet për periudhën riprodhuese të*

*gruas prej moshës 15 deri 49 vjeç, gjegjësisht 18 deri 42 vjeçare, që do të thotë periudha riprodhuese, gjegjësisht reproduktive e nënës, kërkon një mbrojtje shëndetësore të veçantë. Për atë arsye ne edhe e kemi theksuar në këtë formë.*

*KRYESUESI HYDAJET HYSENI:*

*Hedhim në votë amendamentin.*
*Kush është për? Falemnderit.*
*A ka kush kundër? Jo.*
*A abstenon kush? Jo.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 42.*
*Për?*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nu ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 43.*
*Për? Falemnderit.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 44.*
*Për? Shumica.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 45.*
*Për? Shumica.*

*Kundër? 1.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 46.*
*Për? Shumica.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 47.*
*Për? Shumica.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 48.*
*Për?*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 49.*
*Për? Shumica.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 50.*
*Për?*
*Kush është kundër?*
*Abstenime? 1.*
*Aprovohet.*

*A pajtoheni që, meqë nuk është e domosdoshme në amendamente të numërohen edhe votat kundër dhe abstenimet kur janë "për" shumica e dukshme, të shkojmë me vetëm "për".*

*(Ndërhyrje – pa kyçje të mikrofonit)*

*Me procedurë jam dakord, por Kuvendi ka drejtë të marrë vendime procedurale dhe janë të plotëfuqishme, nëse nuk i shkelim. Mirë shumë.*

*Amendamenti 51.*
*Kush është për? Është shumica.*
*A mund ta konsiderojmë se aprovohet?*

*(Reagim – nuk kyçet mikrofoni)*

*Kush është kundër? Askush.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Pra, aprovohet pa kundër dhe pa abstenime.*

*Amendamenti 52.*
*Për? Shumica.*
*Kundër? 1.*
*Abstenime? 1.*
*Aprovohet me shumicë votash.*

*Amendamenti 53.*
*Kush është për?*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 54.*
*Për?*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? 1.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 55.*
*Ia vlenë ky amendament të shikohet, por...?*
*Kush është për?*
*Kundër?*
*Abstenime?*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 56.*
*Kush është për?*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 57.*
*Kush është për? Shumica, ju falemnderit.*
*A ka kundër? Nuk ka.*
*Abstenime?*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 58.*
*Kush është për? Falemnderit.*
*Kundër? 1.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 59.*
*Urdhëroni, ju lutem...*

***(Ndërhyrje për sqarim – nuk kyçet mikrofoni)***

*Dakord. Sqarimin e dëgjuat. Është fjala për sqarimin që u dha nga zonja Gash.*
*Pyes deputetët – a e përkrahin amendamentin me sqarimin plotësues që u dha, edhe pse është shumë e pazakonshme tani në këtë mënyrë verbale të bëhet, pa u shkruar diku.*

*Pyes deputetët – kush është për propozimin me vërejtjen?*

*Kush është kundër? 2.*
*Abstenime? 1.*
*Aprovohet me shumicë votash.*

*Amendamenti 60.*
*Kush është për? Shumica, ju falemnderit.*
*A ka votë kundër?*
*Abstenime?*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 61.*
*Kush voton për?*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 62.*
*Për?*
*Kundër? S'ka.*
*Abstenime? 1 abstenim.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 63.*
*Kush voton për?*
*A ka votë kundër? S'ka.*
*Abstenime? S'ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 64.*
*Për? Shumica.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 65.*
*Kush voton për?*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet njëzërit.*

*Amendamenti 66.*
*Për? Shumica.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet njëzërit.*

*Amendamenti 67.*
*Për? Shumica.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet njëzërit.*

*Amendamenti 68.*
*Për?*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet njëzërit.*

*Amendamenti 69.*
*Për?*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet njëzërit.*

*Amendamenti 70.*
*Për?*
*Kundër? 1.*
*Abstenime? 2.*
*Aprovohet me shumicë votash.*

*Amendamenti 71.*
*Kush është për?*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet njëzërit.*

*Amendamenti 72.*
*Për?*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet njëzërit.*

*Amendamenti 73.*
*Kush është për?*
*Kush është kundër? 1.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 74.*
*Për? Shumica.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? 1.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 75.*
*Për? Shumica, ju falemnderit.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 76.*
*Për?*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? 1.*

*Urdhëroni. Deputeti zoti Hasan Meta e kërkon fjalën.*

*HASAN META:*

*...aty ku është shkruar termi. "Substanca kimike" nuk është e thënë që është "substancë toksike". Unë jam për atë që të zëvendësohet "kimike" me "substancë toksike".*

*KRYESUESI HYDAJET HYSENI:*

*Ju mund të keni të drejtë, por t'ju them të drejtën mendoj se nga ana procedurale tani ne kemi vështirësi nëse lejojmë presedane të tilla. Amendamentet mund të shqyrtohen vetëm nëse janë shqyrtuar paraprakisht nga komisioni funksional. Prandaj, megjithë mirëkuptimin, mendoj se nuk është tani koha kur mund të bëhen këto dhe është dashur këto të bëhen më herët.*

*HASAN META:*

*Ju lutem. Kjo është çështje e rrezikimit, domethënë - radioaktiviteti dhe substancat kimike, dhe mund të jenë edhe toksike dhe t'i shtohet ajo "toksike". Në rregull, por unë kështu mendoj.*

*KRYESUESI HYDAJET HYSENI:*

*Por unë po e përsëris. Ne tani shqyrtojmë amendamentet që kanë rrespektuar procedurën dhe janë shqyrtuar nga Komisioni funksional dhe nuk kemi mundësi që të bëjmë përjashtime. Eventualisht po të jetë se i gjithë Komisioni pajtohet, kjo do të mund të merrej parasysh, por nuk jam për atë që t'bëjmë lëshime. E ka fjalën zoti Xhemajli.*

*BAJRUSH XHEMAJLI:*

*Po ne bëmë përjashtim dhe bëmë presedanin pak më parë me zonjën Gash. Tash pse s'po e bëjmë për këtë çështje kur është shumë më e lehtë se ajo e para. Edhe bile u votua me atë presedan që u bë.*

*KRYESUESI HYDAJET HYSENI:*

*Edhe nëse kemi bërë një lëshim, s'është mirë t'i bëjmë dy.*

*BAJRUSH XHEMAJLI:*

*Po tash, ose mos të bëhet asnjë lëshim, ose të shkojë dhe të vlejë për të gjithë parimi, e jo ndryshe...!?*

*KRYESUESI HYDAJET HYSENI:*

*Tjetër është nëse Komisioni përkatës funksional pajtohet me një mendim. Është megjithatë Komisioni i autorizuar që të japë mendimin për ato amendamente dhe nëse Kuvendi pastaj e përkrahë, është çështje tjetër. Nëse edhe sygjerimin e zotit Meta e përkrahë Komisioni funksional, kjo e ndërron çështjen – për mendimin tim.*

*Prandaj, hedh propozimin në votim.*
*Kush është për amendamentin 76, kështu siç është?*
*Urdhëroni dhe më falni se s'të paskna vërejtur. E ka fjalën zonja Brovina.*

*FLORA BROVINA:*

*Substancat radioaktive dhe substancat kimike-toksike kanë logjikë, ndërsa substancat kimike, kur thuhet mund t'mos jenë edhe toksike. Prandaj, s'ka logjikë këtu. Po i mungon këtu fjala "toksike". Unë besoj se Komisioni kështu do të pajtohet. Ndoshta është bërë lëshim. Ka menduar në "toksike" dhe nuk e ka shkruar.*

*KRYESUESI HYDAJET HYSENI:*

*Të falemnderit zonja Brovina. Unë mund t'ju them se kam një mori vërejtjesh, po ashtu por mendoj se, nëse nuk janë shqyrtuar dhe eventualisht nëse Komisioni pajtohet, mund të merren në shqyrtim. Lus përfaqësuesin e Komisionit të deklarohet – a pajtohet me ndryshimin e sygjeruar.*

*Prandaj, nëse Komisioni qëndron në propozimin e vet, qoftë edhe e gabuar, ne nuk kemi rrugë tjetër pos ta votojmë si të tillë.*

*Kush është për propozimin e Komisionit? Ju lutem le të numërohen votat.*
*38 vota janë për.*
*Kush është kundër amendamentit të propozuar? Të numërohen votat, ju lutem.*

*Sipas rezultatit të votimit, del se 38 deputetë kanë votuar për amendamentin; 14 kanë votuar kundër.*
*Pyes – kush abstenon? 1 abstenim.*
*Konstatoj se aprovohet amendamenti ashtu siç ishte në propozimin e Komisionit.*

*Amendamenti 77.*
*Kush është për?*
*Kush voton kundër? Askush.*
*A ka abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet njëzërit.*

*Amendamenti 78.*
*Kush është për? Është shumica.*
*A ka vota kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet njëzërit.*

*Amendamenti 79.*
*Kush është për?*
*Kundër? 1.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 80.*
*Kush është për? Shumica.*
*A ka votë kundër? 1.*
*A abstenon kush? 1.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 81.*
*Kush është për?*
*Kundër? Nuk ka.*

*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 82.*
*Kush është për?*
*Kundër?*
*Abstenime?*
*Aprovohet njëzërit.*

*Amendamenti 83.*
*Për? Falemnderit.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 84.*
*Për? Shumica.*
*Kundër?*
*Abstenime?*
*Aprovohet me shumicë votash.*

*Amendamenti 85.*
*Kush është për?*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 86.*
*Kush është për? Shumica.*
*A ka votë kundër? 1.*
*A abstenon kush? 1.*
*Aprovohet me shumicë votash.*

*Amendamenti 87.*
*Kush është për? Shumica.*
*A ka votë kundër?*
*A abstenon kush? Jo.*
*Aprovohet.*

*Vërtetë, kjo vota kur po duket qartë se deklarohet shumica, është krejt e panevojshme... Nëse dojmë e vazhdojmë por kështu është.*

***(Reagime – nuk kyçet mikrofoni)***

*N'dakord.*

*Amendamenti 88.*
*Kush është për? Shumica.*
*Kush voton kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet njëzërit.*

*Amendamenti 89.*
*Kush është për?*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 90.*
*Kush është për?*
*Kundër? 1 votë kundër.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 91.*
*Kush është për? Shumica.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 92.*
*Kush është për?*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 93.*
*Kush është për? Shumica.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 94.*
*Për? Shumica.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 95.*
*Për? Shumica.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Amendamenti 96.*
*Fjalën e ka kërkuar deputetja Teutë Hadri. Urdhëroni...*

*TEUTË HADRI:*

*...që këtë amendament 96 mos ta miratojnë në bazë të Komisionit të buxhetit, për shkak se mjetet e derdhura nga gjobat të derdhen në buxhetin e konsoliduar të Kosovës për shkak se të gjithë jemi të ballafaquar me faktin e Ministrisë që mjetet të derdhen në Minsitrinë e Shëndetësisë kur e dijmë se Ministria e Shëndetësisë e ka nga buxheti i konsoliduar i Kosovës një shumë shumë të vogël. Prandaj, propozoj që të gjithë deputetët të kenë mirëkuptim që ky buxhet të derdhet në Ministrinë e Shëndetësisë, nëse të gjithë pajtohen.*

<u>*KRYESUESI HYDAJET HYSENI:*</u>

*Mendoj se është krejt në rregull që gjatë shqyrtimit të amendamenteve të jetë një paraqitje e atyre që janë për amendamentin, një prej atyre që kundërshtojnë amendamentin, prandaj mendoj se duhet të kuptohet si e drejtë e deputetes për ta argumentuar qëndrimin e vet. E kryet apo...*

<u>*TEUTË HADRI:*</u>

*Unë desha vetëm ta arsyetoj, kur dihet buxheti i shëndetësisë si është i ndarë nëse ne ia lëmë buxhetin Kosovës dhe për shëndetësi shumë pak po mendohet dhe po ndahet një ndarje jo e drejtë, qysh ka qenë, sepse ne ballafaqohemi me krizën në shëndetësi...*

<u>*KRYESUESI HYDAJET HYSENI:*</u>

*Përfaqësuesi i Komisionit për buxhet, zoti Haki Shatri. Urdhëroni ju lutem.*

<u>*HAKI SHATRI:*</u>

*Falemnderit. Unë mendoj se ky amendament duhet të votohet, sepse në të gjitha rastet është vepruar kështu dhe argumenti qëndron në këtë: Nuk forcohet as nuk përmirësohet pozita materiale e shëndetësisë me gjoba. Kjo është një rregull normale buxhetore. Të gjitha dënimet që aplikohen qoftë në komunikacion, qoftë në fusha tjera – është rregull që detyrimisht duhet të derdhen në buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe kur bisedohet për aprovimin e buxhetit atëherë mund të flasim se sa dhe si do ta forcojmë bazën materiale të një aspekti jetësor, qoftë në shëndetësi, qoftë në kulturë dhe qoftë në çfarëdo lëmie tjetër. Ju falemnderit.*

<u>*KRYESUESI HYDAJET HYSENI.*</u>

*Falemnderit. Dëgjuat arsyetimet e kundërta të ndryshme, të dy qëndrimeve. Prandaj ne hedhim në votim propozimin e amendamentit, kështu siç është.*

*Kush është për? Shumica.*
*Kush është kundër? 3 vota kundër.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet amendamenti ashtu siç është.*

*Amendamenti 97 ka tri nënamendamente dhe jo të gjitha të një natyre. Jo, në të vërtetë nuk është nën një, sepse i pari ka të bëjë megjithatë me çështje përmbajtësore dhe i dyti ka të bëjë me çështje terminologjike, prandaj unë do të thosha që s'pari ta aprovojmë këtë nën a).*

*Kush është për? Shumica.*
*Kush është kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet.*

*Nënpikat b) dhe c) të amendamentit 97 - meqë janë terminologjike, mund t'i aprovojmë am bllok.*

*Kush është për dy nënpikat e amendamentit? Ju falemnderit.*
*A ka votë kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*

*Ju lutem për mirëkuptim, por mendoj se praktikën që të votojmë shumë amendamente përnjëherë, vërtetë s'mund ta lejojmë, sepse mund të pajtohesh me një çështje dhe mund t'mos pajtohesh me çështjen tjetër dhe le të rrespektojmë vullnetin e deputetëve.*

*Amendamenti 98.*
*Kush është për?*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Aprovohet njëzërit.*

*Amendamenti 99.*
*Kush është për?*
*Kush është kundër? Askush.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Konstatoj se aprovohet amendamenti.*

*Dhe, amendamenti i fundit – 100.*
*Kush është për?*
*Kush është kundër?*
*A abstenon kush? Jo.*

*Konstatoj se edhe amendamenti 100 aprovohet njëzërit.*

*Me kaq shterrojmë listën e amendamenteve.*
*Prandaj, tani hedhim në votim Projektligjin si tërësi me amendamentet e aprovuara.*

*Kush është për? Është shumica.*
*A ka vota kundër? Nuk ka.*
*A ka abstenime? Nuk ka.*

*Konstatoj se Kuvendi aprovoi njëzërit Ligjin për shëndetësinë.*
*Pak si post festum: Të pranishëm në sallë janë 71 deputetë.*

*(Duartrokitje)*

---

*Votimi – Glasanje – Voted:*
- *Për – Za – For ........................Shumica – Većina – Majority...........*
- *Kundër – Protiv – Against .........................00..................*
- *Abstenime – Uzdržani – Abstaned.............00...................*

---

*Është e jona të vendosim bashkërisht a të vazhdojmë punën kështu apo të bëjmë pauzë? Dakord.*

*Në radhë kemi shqyrtimin e projektligjit të tretë për këtë seancë të pasditës – Projektligjin për bashkëpunimin me Tribunalin Penal të Hagës.*

*Të nderuar deputetë. Edhe ky ligj, si edhe shumë ligje tjera, janë miratuar në parim kohë më parë dhe iu janë shpërndarë deputetëve sipas procedurës së paraparë. Mund të them madje që disi me afate do të duhej të kishim kujdes më shumë sepse po na shtyhen shumë shqyrtimi i dytë dhe kjo mund të jetë një mangësi e punës sonë.*

*Komisionet kanë shqyrtuar Projektligjin dhe kanë dhënë rekomandimet e tyre, si vijon:*

*Komisioni për gjyqësi, legjislacion dhe kornizë kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji ka bazueshmërinë në Kornizën kushtetuese dhe njëherit në cilësinë e Komisionit funksional ka propozuar amendamente dhe është deklaruar për amendamentetet e Koalicionit "Kthimi" dhe të deputetit Bujar Dugolli, të cilat do të procedohen për votim.*

*Komisioni për buxhet ka vlerësuar se Projektligji, me amendamentet e propozuara, nuk përmban implikime të papranueshme financiare dhe buxhetore.*

*Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve ka vlerësuar se me këtë ligj nuk cenohen të drejtat dhe interesat e komuniteteve.*

*Pyes deputetët, përfaqësuesit e grupeve ose të komisioneve nëse duan të marrin fjalën. Për fjalë është paraqitur përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zoti Arsim Bajrami. Më falni, paraqiteni ndoshta në emër të Komisionit?*

***ARSIM BAJRAMI:***

*Në emër të Komisionit. Komisioni për çështje legjislative dhe kornizë kushtetuese ka qenë Komisioni funksional në këtë Projektligj dhe ai ka bërë dy amendamente kryesore që shprehin edhe vetë konceptin e ligjit. Amendamenti i parë është që ky ligj të trajtohet si ligj për shkak se ne nga Qeveria e kemi marrë si projektlegjislacion, pra një shprehje e pazakonshme në praktikën legjislative dhe insistojmë që Kuvendi ta miratojë si ligj, meqenëse edhe procedurat e shqyrtimit të këtij ligji kanë shkuar identik me procedurat tjera ligjvënëse.*

*Pra, po e shihni amendamentin e parë që ne kemi propozuar ndërron vetë emërtimin e aktit të cilin e ka përcjellë Qeveria.*

*Ndërkaq, në amendamentin e dytë kemi insistuar që autoritet kompetent në Kosovë për bashkëpunimin me Tribunalin e Hagës të jetë Qeveria e Kosovës. Qeveria e Kosovës pastaj, më vonë, me një akt të vetin të brendshëm do të përcaktojë se cila nga ministri apo cili segment i Qeverisë do të merret me këtë çështje, por meqenëse ka mbet pezull në Projektligj çështja e autoritetit kompetent për bashkëpunimin me Tribunalin e Hagës, ne kemi insistuar që Qeveria e Kosovës... Natyrisht këtu jemi të vetëdijshëm që mund të ketë edhe kompetenca Përfaqësuesi Special, por dëshirojmë që brenda kompetencave që i njihen Qeverisë së Kosovës ajo të ketë autoritet për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës.*

*Ndërkaq, ne kemi marrë edhe një grup amendamentesh të deputetit Bujar Dugolli dhe të Koalicionit "Kthimi" dhe lidhur me to kemi dhënë mendimin tonë. Ju falemnderit.*

***KRYESUESI HYDAJET HYSENI:***

*Falënderojmë zotin Bajrami. Fjalën e ka zoti Bujar Dugolli.*

***BUJAR DUGOLLI:***

*Ju falemnderit, zoti kryesues. Unë desha të flas... Nejse lidhur me rëndësinë e këtij ligji kemi folë, domethënë edhe në leximin e parë. Mua më habit rasti se Komisioni funksional nuk i ka marrë seriozisht disa amendamente që janë propozuar nga unë, që faktikisht kanë qenë preokupim edhe në leximin e parë të këtij ligji që është bërë nga të gjitha grupet politike lidhur me sqarimin për autoritetin kompetent, lidhur me sqarimin e rolit të Qeverisës ë Kosovës në raport me qytetarët e*

*saj që mund të akuzohen apo të dënohen nga Tribunali dhe unë jam përpjek që t'i bëj disa amendamente të cilat do t'ia dhënë rëndësinë e vet këtij ligji, sepse po i miratojmë në Kuvendin e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës duhet të jetë ai i cili duhet ta emërojë edhe autoritetin kompetent në bazë të formulës siç e kam propozuar në amendamente.*

*Mendoj se në rast që nuk kalojnë këto amendamente, atëherë kjo mund të quhet rregullore e UNMIK-ut, por nuk mund të quhet ligj që e ka miratuar Kuvendi sepse nuk e ka atë brumin e duhur që të jetë ligj i pranueshëm për qytetarët apo për institucionet e Kosovës.*

*Unë jam i kënaqur se Komisioni faktikisht i ka përkrahur 3 amendamente, por nuk i ka përkrahë 4 amendamente që për mendimin tim janë kryesore dhe esencë e këtij ligji.*

*Derisa të funksionojë pranë Qeverisë së Kosovës Ministria e Drejtësisë atëherë duhet të jetë një mekanizëm miks i formuar nga institucionet e Kosovës, nga gjykatat, nga Qeveria, nga Përfaqësuesi Special – nëse dëshirojmë që ky ligj të merrë dritën jeshille për t'u aplikuar. Dhe ne e dijmë se është shumë me rëndësi për ta pasë Kosova këtë ligj, sepse të gjitha rastet që kanë ndodhë në Kosovë janë bazuar në ligjin e Serbisë mbi bashkëpunimin me Tribunalin e Hagës.*

*Prandaj, nëse ne i aprovojmë dhe them t'bëhet edhe Komisioni pak më tolerant dhe të përkrahen nga deputetët këto amendamente, mendoj se do ta bëjmë një ligj shumë të mirë dhe në momentin kur përgjegjësitë do të transferohen tek Qeveria e Kosovës dhe të funksionojë Ministria e Drejtësisë, normalisht do të ketë forma që ne me amendamente ta definojmë rolin e Qeverisë.*

*Dhe, unë kam frikë se, në rast se qitet vetëm roli i Qeverisë kështu vetëm sa për të thënë, ky ligj mund t'mos kalojë. Prandaj amendamentet që i kam propozuar janë të t'holluara shumë mirë dhe shpresojmë se mund të kalojë ligji. Prandaj, kërkoj nga deputetët që t'i përkrahin. Ju falemnderit.*

***KRYESUESI HYDAJET HYSENI:***

*Falemnderit zoti Dugolli. Pasi që nuk ka të paraqitur të tjerë, mendoj se deputetët do t'i kenë parasysh ato që u thanë dhe ne do të vazhdojmë me shqyrtimin e amendamenteve të propozuara.*

*Kemi numër jo shumë të madh të amendamenteve dhe mendoj se kësaj radhe nuk kemi nevojë të ngutemi si herën e parë.*

*Amendamenti 1, Komisioni funksional dhe deputeti Bujar Dugolli.*
*Kush është për? Është shumica.*
*Kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Konstatoj se aprovohet amendamenti 1.*

*Amendamenti 2. Komisioni funksional.*
*Kush është për? Është shumica.*
*Kush është kundër? 3.*
*A ka abstenime? 1 abstenim.*
*Aprovohet me shumicë votash.*

*Amendamenti 3.*

***(Reagim – nuk kyçet mikrofoni)***

*Në rastet kur amendamenti paraprak e absolvon, si të thuash, edhe materien e amendamentit tjetër, konsiderohet se është votuar automatikisht edhe për të, kështu që mendoj se vërejtja duhet të merret parasysh.*

*A pajtohet Kuvendi me këtë vlerësim?*

***(Reagim – nuk kyçet mikrofoni)***

*Do të thotë që dy amendamentet pasuese të mos shqyrtohen, sepse votuam për amendamentin që e absolvon edhe këtë. Ose, lus deputetët që ta sqarojnë qëndrimin e tyre për t'mos u vë në pyetje. Urdhëroni zoti Bajrami.*

*ARSIM BAJRAMI:*

*Mendoj se kjo është e qartë, meqenëse ne me amendamentin 2 përcaktuam Qeverinë e Kosovës si autoritet kompetent.*

*Amendamenti 3 dhe 4 përcaktojnë një mekanizëm tjetër, siç ka propozuar zoti Dugolli.*

*Ne votuam amendamentin 2, dhe në fakt ne vendosëm që Qeveria e Kosovës të jetë autoritet kompetent.*

*Unë mendoj se të njëjtën punë, që po propozon zoti Dugolli ta bëjë Kuvendi, mund ta bëjë edhe Qeveria dhe Qeveria mund të vendosë që ta formojë një trup brenda Qeverisë, një organ të përzier brenda Qeverisë që ajo të jetë kompetente për bashkëpunimin me Tribunalin e Hagës. Kështu që ne vetëm po bartim këtë çështje në ekzekutiv. Meqenëse ekzekutivi është shumë më homogjen dhe është, do të thoja, më mobil meqenëse është në përbërje javore, ndërkaq Kuvendi mund të vonojë edhe themelimin e këtij institucioni, kështu që në këtë rast është krejt i pakuptimt votimi për amendamentin 3 dhe 4, sepse ai është i paobjekt.*

*KRYESUESI HYDAJET HYSENI:*

*Falemnderit. E ka fjalën zoti Dugolli.*

*BUJAR DUGOLLI:*

*Unë mendoj se Qeveria - po të donte ta definonte, që në leximin e parë do ta definonte se autoriteti kompetent është Qeveria. Po tash të gjithë e dini fortë mirë se kjo çështje nuk është krejt e Qeverisë por është e përzier. Prandaj, ju tash e votuat Qeverinë. Normalisht se tash këto bijnë këto formulime, por as Qeverisë s'i keni lënë metodë se si do ta zgjidhë dhe qysh përbëhet ky trup kur ne nuk e kemi atë mekanizëm të drejtësisë brenda Qeverisë. Ju falemnderit. Këtë e pata vetëm si sqarim.*

*KRYESUESI HYDAJET HYSENI:*

*Nuk mund të kontestohet vërejtja e zotit Dugolli dhe ne në fillim e kishim këtë çështje – pse nuk është përfaqësuesi i Qeverisë, por përgjegja na u dha se meqë është marrëveshje midis Komisionit përkatës funksional dhe Qeverisë gjatë procesit paraprak, do të thotë nuk ishte e domosdoshme. Përndryshe, konsideroj se është e nevojshme gjithmonë që sponsorizuesi i ligjit të jetë këtu dhe t'i sqarojë pozicionet e veta me secilin amendament. Nëse ne ndonjëherë s'ia kemi krijuar këtë mundësi, ka qenë lëshim yni, por mendoj se është e domosdoshme kjo. Por, kësaj*

*radhe, meqë ne votuam amendamentin 2, i cili i përjashton amendamentet 3 dhe 4, do të vazhdojmë me amendamentet tjera.*

*Amendamenti 5, Koalicioni "Kthimi", pa përkrahje nga Komisioni funksional.*
*Kush është për? Nuk ka vota për.*
*Kundër? Shumica kundër.*
*Abstenime? Nuk ka.*
*Nuk kalon amendamenti.*

*Amendamenti 6, Koalicioni "Kthimi", pa përkrahje nga Komisioni funksional.*
*Kush është për? Nuk ka për.*
*A ka votë kundër? Shumica kundër.*
*A ka abstenime? Nuk ka.*
*Nuk kalon amendamenti.*

*Amendamenti 7, Koalicioni "Kthimi", pa përkrahje nga Komisioni funksional.*
*Kush është për? Nuk ka votë për.*
*Kush është kundër? Shumica kundër.*
*A ka abstenime? Nuk ka abstenime.*
*Nuk kalon amendamenti.*

*Amendamenti 8, Koalicioni "Kthimi" pa përkrahje nga Komisioni funksional.*
*Kush është për? Nuk ka votë për.*
*A ka votë kundër? Është shumica.*
*A ka abstenime? Nuk ka.*
*Hudhet poshtë amendamenti.*

*Amendamenti 9, deputeti Bujar Dugolli, pa përkrahje nga Komisioni funksional.*

*E ka fjalën propozuesi i amendamentit.*

***BUJAR DUGOLLI:***

*Pasi që ato u zgjedhën ashtu, në rregull – kërkoj që ky amendament të përkrahet sepse është konform me atë që kemi kërkuar të gjitha grupet parlamentare para mediave. Ju kujtohet, ne kemi pasë një rast që një kolegë yni është akuzuar dhe tani gjendet në Tribunalin e Hagës dhe të gjithë jemi deklaruar për mbrojtjen e tij dhe kemi deklaruar se nuk po kemi mekanizëm ligjor të garantojmë ndihmën juridike dhe materiale. Pra të gjitha grupet parlamentare kanë kërkuar që me ligj të rregullohet kjo çështje ku do të garantohet një mbrojtje juridike por edhe mbrojtje materiale për ato familje të cilat nuk kanë mundësi ndoshta as materiale për të shkuar e për t'i vizituar të akuzuarit dhe ne kemi raste të para që familjet ballafaqohen me raste shumë të rënda materiale, kështu që mendoj se kjo çështje është sa e mirë e normale - është edhe humanitare dhe kërkoj që ky amendament të përkrahet e të ekzistojë në ligjin tonë dhe kjo çështje të merret parasysh në të ardhmen edhe nga Qeveria e Kosovës. Ju falemnderit.*

***KRYESUESI HYDAJET HYSENI:***

*Të falemnderit zoti Dugolli. Fjalën e ka zoti Arsim Bajrami.*

*ARSIM BAJRAMI:*

*Të falemnderit zoti kryesues. Meqë s'kam prezentu në mbledhjen e Komisionit kur është shqyrtuar ky amendament unë – jo në emër të Komisionit, por në emërin personal dhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës i jap mbështetje këtij amendamenti dhe mendoj se ka bazë ligjore për shkak se ky ligj parasheh, pos tjerash, që Kosova ta ketë zyrën pranë Tribunalit të Hagës që do të akreditohet si partnere për bashkëpunimin me Tribunalin e Hagës dhe është e natyrshme që kjo zyre, që do të jetë zyre e Kosovës pranë këtij Tribunali, të ka obligime që t'u ofrojë ndihmën e nevojshme personave që akuzohen nga ky Tribunal.*

*Mendoj se me këtë ne vetëm po realizojmë atë që e kemi folë. Kjo është sidomos e nevojshme kur ky Tribunal akuzon apo fillon procedura ndaj zyrtarëve të Kosovës, ndaj personaliteteve që janë zyrtar të lartë të Kosovës dhe që janë përfaqësues të popullit, në një mënyrë. Meqenëse këtu ne kemi pasë një rast që, një nga deputetët – kolegut tonë zoti Limaj është akuzuar nga ky Tribunal, mendoj se kemi jo vetëm obligim moral por tani kemi edhe rastin që të krijojmë edhe bazën ligjore juridike që institucionet e Kosovës të përkujdesen për njerëzit e vet, për njerëzit që janë në institucione dhe me këtë ne, në një mënyrë, po i krijojmë bazë legale zyrës së Kosovës që do të formohet pranë këtij Tribunali.*

*Në qoftë se ligji parasheh se nga buxheti i Kosovës do të afrohet asistencë ligjore dhe materiale, mbrojtje juridike njerëzve tanë, atëherë ne vetëm po i mbrojmë njerëzit tanë, natyrisht po i mbrojmë për shkak se ata derisa nuk dënohen me një aktgjykim të formës së prerë janë të pafajshëm dhe për ne konsiderohen si të tillë.*

*Andaj, unë lus që edhe deputetët tjerë të kenë mirëkuptim dhe ta përkrahim këtë amendament meqenëse me këtë ne po përkrahim në një mënyrë edhe institucionet e Kosovës.*

*KRYESUESI HYDAJET HYSENI:*

*Falemnderit zoti Bajrami. Qeveria e Kosovës, si çdo qeveri tjetër, duhet të mbrojë interesat e Kosovës dhe qytetarët e Kosovës, prandaj mendoj se është shumë me vend.*

*E vë propozimin në votim.*
*Kush është për propozimin e amendamentit të propozuar? Ju falemnderit.*

***(Reagim – nuk kyçet mikrofoni)***

*Po ne filluam votimin, ju lutem, tash. Pra, përsëris edhe një herë:*

*Dhe, përsëris edhe një herë: Kush është për amendamentin 9 të propozuar dhe të arsyetuar pak më parë?*

***(Reagim – nuk kyçet mikrofoni)***

*Ju lutem – një: kemi filluar procesin e votimit, dhe e dyta: për amendamente është paraparë procedura vetëm një deklarim "për" dhe një deklarim "kundër".*

*Kush është kundër? Le të numërohen votat, ju lutem.*

***(Reagim – nuk kyçet mikrofoni)***

*Ju lutem, nuk ka nevojë këtu për kurrfarë paqartësie. A u numëruan votat, ju utem. Votohet amendamenti që i është bashkëngjitur dhe shpërndarë deputetëve. Meqë ende s'janë numëruar votat, atëherë po e përsërisim edhe një herë votimin.*

*Amendamenti që është para jush dhe që u arsyetua pak më parë nga dy folës, hidhet në votë.*

*Kush është për këtë amendament? Lus Sekretarinë që t'i numërojë votat.*
*Kush është kundër amendamentit? Nuk ka kundër.*
*E përsëris: a ka vota kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? Le të numërohen votat.*
*Aprovohet amendamenti i propozuar, sipas procedurës me të cilën ne punojmë.*

*Ju lutem, mos m'u përzieni...Jo, jo. Amendamentet, ju lutem, votohen me shumicën e votave të atyre që votojnë "për" ose "kundër". "Për" ishin 27 vota; "kundër" s'kishte asnjë, "abstenimet" nuk kanë lidhje me shumicën. Kjo është vetëm sa për ta bërë të plotëfuqishme dhe ne kemi pasë jo më pak se në një seancë përpara.*

***(Ndërhyrje nga Sekretaria – nuk kyçet mikrofoni)***

*Nuk është gabim, të lutem. Dhe megjithatë, derisa jam unë këtu - unë interpretoj dhe kështu kemi vepruar. Ky është i vetmi interpretim i drejtë i procedurës së votimit dhe kjo çështje le t'i mbetet përsëri pastaj, siç jemi marrë vesh në seancën e sotme, Komisionit për ta shqyrtuar. Por unë mund t'i citoj tani nenet edhe të Kornizës kushtetuese edhe të Rregullores sonë dhe në të gjitha ato votimi merret me shumicën e votave të atyre që votojnë "për" ose "kundër". Këtu nuk numërohet numri i atyre që abstenojnë, ju lutem. Dhe, këtu s'ka dilema. Prandaj, vazhdojmë më tutje.*

*Amendamenti 10, Bujar Dugolli, pa përkrahje nga Komisioni funksional.*
*Kush është për? Ju lutem, numëroni votat.*
*Kush është kundër? Ju lutem, numëroni votat.*
*Në sallë janë 68 deputetë dhe do të thotë votimi është i rregullt. 24 deputetë janë "për"; 14 janë "kundër".*
*A abstenon kush, për të mos mbetur mangët? 3 abstenime. Ju falemnderit.*
*Do të thotë 24 vota "për"; 14 "kundër", 3 "abstenime" – aprovohet amendamenti.*

*Shkojmë më tutje. E ka kërkuar fjalën deputeti Sabit Rrustemi. Ju lutem vetëm për amendamentet.*

*SABIT RRUSTEMI:*

*Pikërisht është fjala për amendamentin, zoti kryesues. Në Projektligjin, që na ka ardhur nga Qeveria e Kosovës, shkruan në mënyrë decidive: për këtë Projektlegjislacion nuk do të ketë votim në Kuvend, por për të mund të parashtrohen komente, gjegjësisht amendamente të cilat përmes Qeverisë do t'i përcillen PSSP dhe të njëjtat do t'i ketë në konsiderim gjatë procedurës finalizuese.*

*Unë jam për atë që të gjitha amendamentet që janë paraqitur t'i përcillen po kësaj Qeverie e të mos votojmë fare, sepse po votojmë vetëm formalisht. Do të thotë, po bëjmë punë të kotë.*

**<u>KRYESUESI HYDAJET HYSENI:</u>**

*Të falemnderit zoti Rrustemi, por s'pari kjo vërejtje është shumë vonë, dhe s'dyti - ne kemi ditur këtë vërejtje, e kemi pasë që në fillim dhe nëse t'kujtohet qysh në shqyrtimin e parë është theksuar kjo çështje, por ne nuk kemi mënyrë tjetër si do t'i ndërtojmë qëndrimet tona. Ne bëjmë punën tonë, e pastaj secili le ta bëjë punën e vet.*

*Prandaj, unë them të vazhdojmë me shqyrtimin siç kemi filluar. Këtë çështje kemi mund ta shqyrtojmë që në fillim kur kemi filluar seancën ose në shqyrtimin e parë. Tani është tepër vonë për komente të tilla.*

*Amendamenti 11, Koalicioni "Kthimi", pa përkrahje nga Komisioni funksional.*
*Kush është për? Nuk ka vota për.*
*Kush është kundër? Le të numërohen votat. Është shumica kundër, por Sekretaria le t'i numërojë votat.*
*A ka abstenime?*
*Konstatoj se nuk kalon amendamenti.*

*Amendamenti 12, Koalicioni "Kthimi", pa përkrahje nga Komisioni funksional.*
*Kush është për? Nuk ka votë për.*
*Kush është kundër?*
*A abstenon kush? Nuk ka abstenime.*
*Nuk ka vota për, shumica janë kundër – hudhet poshtë amendamenti.*

*Amendamenti 13, deputeti Bujar Dugolli, me përkrahje nga Komisioni funksional.*
*Kush është për?*
*A ka kush kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? 2.*
*Aprovohet amendamenti me shumicë votash.*

*Amendamenti i fundit – 14, deputeti Bujar Dugolli, me përkrahje nga Komisioni funksional.*
*Kush është për? Është shumica.*
*A ka votë kundër? Nuk ka.*
*Abstenime? 2.*
*Aprovohet amendamenti me shumicë votash.*

*Me kaq përfundon shqyrtimi i amendamenteve të paraqitura në – tani mund të themi – Ligjin për bashkëpunimin me Tribunalin Penal të Hagës.*

*E vë propozimin në votim.*

*Kush është për Ligjin si tërësi? Shumica dërmuese.*
*A ka vota kundër? 3.*
*A ka abstenime?*
*Të numërohen votat, ju lutem. Po, mund të them se është një dyzim votash kundër.*
*Më lejoni ta korrigjoj veten. Janë 11 abstenime.*

*Do të thotë me shumicë absolute votash aprovohet Ligji për bashkëpunim me Tribunalin Penal të Hagës. Ju falemnderit.*

*Votimi – Glasanje – Voted:*

- *Për – Za – For ........................Shumica – Većina – Majority...........*
- *Kundër – Protiv – Against .........................03..................*
- *Abstenime – Uzdržani – Abstaned.............11..................*

*Na kanë mbetur edhe dy pika të rendit të ditës:*

*Nën një - Shqyrtimi i veprimit të strukturave paralele në Kosovë; dhe*
*Nën dy - Përgjegja në pyetjen e deputetëve.*

*Ministrin nuk e kemi këtu, i cili ka paralajmëruar ardhjen e tij. Prandaj, është e jona dhe ka sygjerime që ne të vazhdojmë nesër seancën. Eventualisht mund ta fillojmë sot shqyrtimin...*

*Unë pajtohem do të thotë që ne të hapim shqyrtimin sot edhe të kësaj çështjeje.*
*Siç jeni në dijeni, kjo çështje është inicuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, prandaj pyesim përfaqësuesin e Grupit a dëshiron të marrë fjalën.*

***(Reagim – nuk kyçet mikrofoni)***

*Në dakord. A pajtoheni pra që të bëjmë një pauzë 15 minutëshe e pastaj të vazhdojmë se besoj nuk do t'na zgjatë shumë. Në rregull, por ta rrespektojmë afatin prej 15 minutash e mos t'na shpërndahet përbërja.*

***(Vijon pauza 15 minutëshe).***

***(Pas pauzës, seanca vazhdoi punën).***

*KRYESUESI HYDAJET HYSENI:*

*Të nderuar deputetë, lus për vëmendjen tuaj. Kemi numër të nevojshëm të të pranishmëve. Do të thotë kemi kuorum dhe mund të punojmë.*

*Vazhdojmë me rendin e aprovuar të ditës.*

*Në radhë është – Shqyrtimi i veprimit të strukturave paralele në Kosovë, nismë kjo që është paraqitur nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, prandaj edhe ia japim fjalën përfaqësuesit të saj.*

*ARSIM BAJRAMI:*

*Të nderuar kolegë, zoti kryesues,*

*Dola në foltore për të demonstruar rëndësinë e kësaj teme, të cilën po e diskutojmë. Pra, është një temë shumë e rëndësishme. Do të thoja një temë që po rëndon aktualitetin e Kosovës, një temë që po e sfidon jo vetëm Kosovën por do të thoja edhe vetë rolin e Misionit ndërkombëtar në Kosovë.*

*Kjo temë - nuk ka merituar të diskutohet e fundit. Kjo temë meriton sesion të veçantë dhe debat me pjesëmarrës të shumtë, dhe jo vetëm nga deputetët e Kosovës, por edhe nga përgjegjësit ndërkombëtar dhe përgjegjësit vendor për ta analizuar gjendjen e veprimit të pushtetit paralel dhe për të ndërtuar një strategji që vërtetë i ndalet hovi këtij procesi i cili ka sigurisht reflektime të gjera dhe reflektime që mund të jenë me pasoja finale për statusin e Kosovës.*

*Për këtë arsye, unë mendoj që sot mund ta fillojmë këtë temë dhe mund të hapim një debat parimor në nivel të grupeve parlamentare, por insistoj që kjo temë të jetë temë e veçantë e sesionit të ardhshëm e përgatitur mirë, me pjesëmarrës kompetent dhe me përgatitje kompetente, për shkak se ne - kur kemi kërkuar që kjo të debatohet - nuk kemi dashur vetëm ta shprehim një pakënaqësi me gjendjen e veprimit të pushtetit lokal, por që Kuvendi i Kosovës të ndërtojë një strategji, do të thoja, për tejkalimin e kësaj situate dhe të obligojë institucionet vendore ekzekutive, dhe të bëjë e adresojë kërkesa te komuniteti ndërkombëtar për tejkalimin e kësaj gjendjeje.*

*Për këtë arsye unë angazhohem që sot të kemi një debat parimor. Nuk mund të flas në emër të grupeve tjera parlamentar, por angazhohem që në sesionin e parë të ardhshëm, a do të jetë nesër apo javën e ardhshme, si pikë e vetme të jetë kjo çështje dhe në ndërkohë edhe Kryesia të jetë e obliguar të bëjë përgatitje kualitative që kjo mbledhje të jetë vërtetë përmbajtësore.*

*Unë do të prezentoj qëndrimin e Grupit Parlamentar dhe në fund do të propozoj edhe disa konkluzione.*

*Siç dihet, Rezoluta 1244 dhe Korniza kushtetuese, në kreun 1, pika 1.2 - ka përcaktuar parimin se Kosova është një territor i pandashëm, anëembanë të të cilit ushtrojnë përgjegjësitë e tyre institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes. Edhe dispozitat tjera ligjore kanë përcaktuar tërësinë unike territoriale të Kosovës dhe shtrirjen e autoritetit të UNMIK-ut dhe institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse anëembanë territorit të Kosovës. Ky parim juridik dhe ligjor, tani gati 5 vite pas vendosjes së administrimit ndërkombëtar në Kosovë, nuk po realizohet. Sepse Kosova sot nuk paraqet një tërësi unike territoriale dhe pothuaj në një të tretën e territorit të saj nuk po ushtrohet autoriteti i UNMIK-ut dhe institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes.*

*Strukturat paralele serbe paraqesin sot sfidën më të madhe që po i bëhet Kosovës dhe provokimin më serioz që Serbia i bën Kosovës dhe vetë Misioinit ndërkombëtar në Kosovë. Duke u vënë haptas në përkrahje të strukturave paralele Serbia po destabilizon gjendjen në Kosovë dhe po përfaqëson konceptin e ndarjes së Kosovës në baza etnike, kurse duke krijuar enklava serbe, po bën presion për decentralizimin e pushtetit në baza etnike.*

*Strukturat paralele po shprehen në të gjitha format e jetës në Kosovë, nga të cilat po veçoj:*

- *aplikimi i legjislacionit serb në veriun e Kosovës dhe në të gjitha enklavat serbe;*
- *veprimi i shërbimeve sekrete serbe në Kosovë dhe pjesëmarrja e këtij shërbimi në mënyrë aktive në krimin në Kosovë - në të gjitha format e krimit;*
- *funksionimi i administratës dhe i sistemit gjyqësor paralel serb në të gjitha territoret ku po jeton pakica serbe;*
- *funksionimi paralel i institucioneve arsimore, shëndetësore, kulturore dhe institucioneve tjera;*
- *financimi i këtyre mekanizmave paralel nga vetë buxheti i Serbisë.*

*Siç dihet, përgjegjësia për luftimin e strukturave paralele në radhë të parë bie mbi UNMIK-un, i cili - përveç gjykimeve verbale që po bën çdo ditë ndaj veprimit paralel të pushtetit lokal - nuk po manifeston vendosmëri në shpërbërjen e këtyre strukturave. Për aq më tepër, në një mënyrë, po financon dhe po legjitimon strukturat serbe, sikur ishte vendimi kohë më parë për legjitimimin e të ashtuquajturës "Qendër koordinuese serbe për Kosovën" e cila është themeluese dhe mbështetëse e strukturave paralele në Kosovë.*

*Institucionet e Kosovës tanimë kanë krijuar kuadrin ligjor për integrimin e minoritetit serb në të gjitha format e jetës politike, ekonomike, arsimore dhe shëndetësore.*

*Në nivelin politik tanimë është arritur integrimi i pakicës serbe si në Kuvendin e Kosovës, ashtu edhe në asambletë komunale, bile përtej përfaqësimit real, duke krijuar vende të rezervuara dhe vende të kooptuara në Kuvendin e Kosovës dhe në asambletë komunale.*

*Edhe legjislacioni i Kuvendit të Kosovës në sferën e arsimit, shëndetësisë, ekonomisë dhe në sfera tjera është bazuar në parimin e jodiskriminimit dhe ka krijuar kushte optimale përtej standardeve ndërkombëtare për realizimin e të drejtave të minoriteteve në këto fusha.*

*Përkundër kësaj politike pragmatike dhe konstruktive të institucioneve të Kosovës dhe përkundër kësaj oferte konstruktive që institucionet e Kosovës po i bëjnë minoritetit serb për integrim brenda institucioneve kosovare, ata hezitojnë dhe kundërshtojnë këtë, duke u instrumentalizuar për qëllime të Beogradit dhe duke injoruar proceset demokratike në Kosovë. Këtë e vërteton edhe refuzimi akutal i përfaqësuesve politik të serbëve të Kosovës që të marrin pjesë në grupet punuese të Qeverisë së Kosovës për implementimin e standardeve për Kosovën.*

*Në anën tjetër, edhe Qeveria e Kosovës, sikurse edhe institucionet tjera, ende nuk kanë hartuar një strategji vendore vepruese për shpërbërjen e strukturave paralele dhe për këtë shpeshherë Qeveria dhe institucionet tjera po arsyetohen me sintagmen se kjo është përgjegjësi e rezervuar për UNMIK-un, sintagmë kjo që shprehë paaftësinë tonë për të ndërtuar një strategji vendore efektive vepruese për sigurimin e funksionimit unik të sistemit kushtetues në Kosovë.*

*Rast tipik padyshim i veprimit të strukturave paralele paraqet qyteti i ndarë i Mitrovicës dhe funksionimi i legjislacionit dhe administratës serbe në këtë pjesë. Gjendja në këtë pjesë tani është e padurueshme dhe e paqëndrueshme.*

*Sikur të kishte vendosmëri te autoritetet ndërkombëtare, gjendja në Mitrovicë do të mund të rregullohet për disa ditë. Mirëpo, mendoj se kjo gjendje po mbahet me qëllim e tillë pezull për të reflektuar pozicione të caktuara për Serbinë me rastin e implementimit të statusit final të Kosovës.*

*Duke u nisur nga veprimi paralel i strukturave serbe në Kosovë dhe rreziku që i paraqet ky veprim paqës, stabilitetit, tolerancës ndëretnike dhe perspektivës të të gjithë qytetarëve, propozojmë që Kuvendi i Kosovës të hapë debatin dhe të marrë këto veprime:*

*Nën 1: Kuvendi i Kosovës të kërkojë një raport nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, pastaj nga përfaqësuesi i Shtyllës së katërtë të UNMIK-ut, zoti Zhan Kadi, nga përgjegjësi i Policisë ndërkombëtare, zoti Shtefan Feller që të informojnë Kuvendin e Kosovës për masat që po merr UNMIK-u, Policia ndërkombëtare, KFOR-i dhe strukturat tjera të prezencës civile e ushtarake për shpërbërjen e këtyre strukturave dhe për sigurimin e funksionimit të ligjit në Kosovë dhe në tërë territorin e Kosovës;*

*Nën 2: Kuvendi i Kosovës të kërkojë zyrtarisht nga administrata ndërkombëtare në Kosovë që krahas kërkesës që po bëhet për fillimin e dialogut midis Prishtinës e Beogradit dhe procresit të përmbushjes së standardeve për Kosovën, të kërkojë vendosmëri dhe aksion të menjëhershëm në shpërbërjen e të gjitha strukturave paralele në Kosovë dhe të sigurojë tërësinë unike në tërë hapësirën e Kosovës.*

*Pastaj, Kuvendi i Kosovës të ftojë kryeministrin e Kosovës, kryetarin e Kosovës dhe përfaqësuesit tjerë të institucioneve të Kosovës që të informojnë Kuvendin për problemet dhe masat që ata kanë marrë që ta shtrijnë autoritetin e tyre të njohur brenda tërë territorit të Kosovës, për shkak se dihet që Korniza kushteutese ka obliguar Qeverinë e Kosovës dhe institucionet tjera që të shtrijnë fuqinë e vet kushtetuese që kanë në tërë territorin e Kosovës. Të gjitha ministritë në këtë drejtim kanë probleme dhe ato po kufizohen për shkak se në një pjesë të Kosovës nuk po kanë qasje dhe është mirë që ta informojnë Kuvendin e Kosovës për kufizimet që kanë në këtë drejtim.*

*Pastaj Kuvendi i Kosovës, pas përfundimit të debatit, duhet t'i kërkojë Qeverisë së Kosovës ta përgatisë në mënyrë sa më të shpejtë dhe në afat sa më të shkurtër strategjinë për shpërbërjen e strukturave paralele dhe për realizimin e funksioneve të saja dhe të të gjitha ministrive në tërë territorin e Kosovës.*

*Dhe, në fund – propozojmë që pas debatit dhe pas harmonizimit të qëndrimeve të grupeve parlamentare Kuvendi t'i drejtohet me një kërkesë Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara që Këshilli i Sigurimit, krahas gjykimeve verbale që po i bën kohëpaskohe, qoftë me rastin e raportimit të Përfaqësuesit Special apo të prononcimeve të ndryshme, të miratojë një rezolutë të veçantë - një rezolutë me veprim detyrues me të cilën kërkon shpërbërjen e strukturave paralele dhe ta obligojë UNMIK-un dhe prezencën ushtarake që ta implementojë këtë vendim.*

*Këto ishin vetëm disa propozime, natyrisht pas një debatit, dhe debati të përfundojë atëherë kur t'i kemi përfaqësuesit kompetent. Propozojmë po ashtu që Kuvendi të hapë hapësirë për debat dhe në të t'u mundësojë sa më shumë deputetëve të marrin pjesë. Mendoj se kjo është një çështje ndoshta ndër më të rëndësishmet në politikën e brendshme të Kosovës dhe pastaj të ndërtojmë së bashku një rezolutë dhe ajo rezolutë të reflektojë qëndrimin politik të Kuvendit të Kosovës karshi kësaj sfide që po i bëhet.*

***<u>KRYESUESI HYDAJET HYSENI:</u>***

*Falënderojmë zotin Bajrami. Fjalën e ka kërkuar përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Fatmir Sejdiu. Le të përgatitet përfaqësuesi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.*

*<u>(Ndërhyn Nekibe Kelmendi - nuk kyçet mikrofoni, por kuptohet sa për transkriptim:</u>*
*A po i këqyrni ato sende prej komandës atje, sepse po paraqitem qe disa herë e nuk po e marr fjalën?)*

***<u>KRYESUESI HYDAJET HYSENI:</u>***

*Ju lutem, sa për informimin tuaj. Siç u tha edhe në fillim të seancës sot, edhe sot ne nuk kemi funksionuar sipas teknikës së re, do të thotë edhe të mënyrës së votimit dhe mënyrave tjera.*

*Prandaj, lus përfaqësuesit e Sekretarisë që të shikojnë n'drejtim të deputetëve të cilët eventualisht kërkojnë fjalën, që t'mos mbeten pa u hetuar. Urdhëroni zoti Sejdiu, e keni fjalën.*

***FATMIR SEJDIU:***

*Falemnderit zoti kryesues. Të nderuar zotrinj deputetë,*

*Edhe unë pajtohem se kjo pjesë e debatit që do të fillojë tash sigurisht do të ishte me një qasje metodologjike tjetër më të nevojshme kur të kemi një përgatitje të mirë mbi këtë bazë të prezencës së përfaqësuesve të faktorëve të rëndësishëm, posaçërisht ndërkombëtar në Kosovë, në mënyrë që debati të jetë më i frytshëm dhe rezultatet e tij të jenë të prekshme.*

*Pavarësisht prej kësaj, unë kam për t'i shtruar disa elemente - në bashkëpunim me kolegët e mij deputetë nga Lidhja Demokratike e Kosovës.*

*Edhepse, edhe pak muaj po bëhet viti i pestë i vendosjes së administratës ndërkombëtare në Kosovë, pas intervenimit të forcave të NATO-s dhe të kapërcimit progresiv të përgjegjësive në institucionet e Kosovës, fillimisht të ndërtuara si bashkëqeverisëse dhe në fazën e mëtejshme të dala nga vota e lirë e p opullit, për paradoks, krahas vështirësive objektive me të cilat është përballë dhe përballet edhe sot Kosova, në Kosovë sot ekzistojnë dhe veprojnë - sidomos në pjesë të ndryshme të saj - struktura paralele të nxitura dhe të krijuara nga Serbia dhe që, përkundër dokumenteve ndërkombëtare si Rezoluta 1244 dhe Korniza kushtetuese si dokumenti më i lartë kushtetues në vend të miratuara edhe nga faktorët ndërkombëtar – në Kosovë po bëhet diversion i vazhdueshëm nga këto struktura të cilat për qëllim themelor kanë shkatërrimin e të tashmes e të ardhmes së Kosovës dhe të qytetarëve të saj – përgjithësisht.*

*Çuditërisht, përkundër dokumenteve të lartshënuara dhe qëndrimeve të shprehura të niveleve më të larta ndërkombëtare, deri n ë n ivelin e Këshillit të S igurimit t ë Organizatës së K ombeve të Bashkuara dhe të Sekretarit të Përgjithshëm të saj, këto stuktura, përkundër përpjekjeve jo shumë efikase që të zhbëhen, ato edhe sot e kësaj dite lirshëm veprojnë dhe gjenerojnë pasoja tepër negative në shumë nga sferat e jetës së përgjithshme në Kosovë.*

*Në veçanti, efekti i tyre ka qenë dhe është i orientuar në goditjen e veprimtarive bazike, të sistemit dhe të administratës ndërkombëtare, si në pjesën e përgjegjësvie të saj po kështu edhe në pjesët apo sistemet e përgjegjësive të bartura në institucionet e Kosovës. Kjo është e vrejtshme sidomos:*

1. *Në sistemin e gjyqësisë; me ekzistimin e gjykatave dhe prokurorive paralele të niveleve të ndryshme;*
2. *Në sistemin e institucioneve të sigurisë, përkatësisht me instalimin dhe veprimin e lirshëm të organizmave si "rojet e urës" apo "bandat e urës" në Mitrovicë dhe veprimin e stukturave të sigurimit të punëve të brendshme të Serbisë në shtrirje dhe forma të veprimeve të ndryshme - kujto deklaratën e shefit të sigurimit të këtyre ditëve të sigurimit serb;*
3. *Në sistemin e administratës dhe të shërbimeve publike dhe të qeverisjes lokale - me ekzistimin e s trukturave paralele në komuna d he n ë n jësitë e t yre administrative si n ë shërbimet pronësore-juridike, shërbimet e gjendjes civile dhe shërbimet e tjera;*
4. *Në sistemin e arsimimit duke pasur parasysh sistemin e niveleve të organizimit të tij deri në nivel universiteti;*
5. *Në sistemin e shëndetësisë duke llogaritur këtu veprimet e veçuara shëndetësore dhe të financuara në dy lloj burimesh;*

6. *Në sistemin e telekomunikimit dhe në fusha tjera të operimeve pirateske të Serbisë në pjesë të ndryshme të Kosovës, e të tjera.*

*Kjo gjendje që reflekton si e tillë edhe nga analizat e dala kohëve të fundit të institucioneve ndërkombëtare, posaçërisht dokumenti i emërtuar: Strukturat paralele në Kosovë i tetorit 2003 i OSBE-s, si dhe konstatimet e fundit objektive në nivel të Kombeve të Bashkuara për qenien dhe funksionimin e tyre si dhe nevojën e domosdoshme të shuarjes së tyre dosido rezulton apo gjenerohet nga disa faktorë prezent edhe sot e kësaj dite.*

*Së pari: Përgjatë gjithë periudhës - nga instalimi i administratës ndërkombëtare në Kosovë, ajo si e tillë nuk ka qenë këmbëngulëse, përkundrazi ka toleruar ekzistimin e këtyre strukturave paralele duke sanksionuar gjendjen e akteve fait-acompli të krijaura dhunshëm në pjesë të ndryshme të Kosovës dhe duke lejuar ekzistimin e strukturave dhe të karakterit militar siç janë "rojet e urës" dhe njësitë e sigurimit serb të llojeve të ndryshme që të veprojnë në Kosovë.*

*Së dyti: Është lejuar veprimi i tyre në sfera të ndryshme edhe përmes stimulimit të dyfisht material, posaçërisht në sferën e arsimit dhe të shëndetësisë dhe një veprim i tillë sikur ka dhënë bekimin për vazhdimsinë e punës së tyre deri sot e kësaj dite.*

*Së treti: Në situata të shumta administrata e UNMIK-ut dhe mekanizma të tjerë kanë krijuar raporte partneriteti me struktura të tilla, sidomos kur është fjala për sistemin e gjyqësisë dhe në pjesë të administrimit lokal kur deri më tani është njohur praktikisht validiteti i veprimeve dhe i vendimeve të nxjerra nga to.*

*Së katërti: Është toleruar involvimi i papengesë i faktorit Serbi në krijimin, inkurajimin dhe instruktimin e këtyre strukturave, veçanërisht në fushën e sigurisë dhe të gjyqësisë dhe në sfera tjera të ndieshme, duke mos lejuar po kështu integrimin e shumë qytetarëve të komunitetit serb në proceset aktive të jetës së përgjithshme në Kosovë.*

*Së pesti: Ka ndodhur edhe inkurajimi i këtyre strukturave dhe i veprimtarisë së tyre me veprime të pamatura, siç ka qenë marrëveshja Hakerup-Çoviq.*

*Së gjashti: Bëhen në vazhdimësi pengesa të shumta për qytetarët e Kosovës, sidomos në kushtëzimin e ofrimit të dokumentacionit të lëshuar nga organet serbe dhe që i takon në veçanti sferës së gjendjes civile dhe sidomos me rastin e nxjerrjes së dokumenteve të udhëtimit apo pasaportës së UNMIK-ut dhe dokumenteve të tjera për regullimin e gjendjes civile të qytetarëve.*

*Së shtati: Mungon angazhimi i bollshëm për shtrirjen e validitetit përkatësisht pranimit të dokumentave të lëshuar nga institucionet ndërkombëtare dhe të Kosovës nga ana e vendeve të ndryshme.*

*Nga elementet që u shtruan dhe që mund të ketë edhe shumë të tjera e që dalin si refleks i vështirësive të përgjithshme që kanë institucionet e Kosovës dhe institucionet ndërkombëtare për një funksionim të mirëfilltë në të gjithë tërësinë territoriale të Kosovës, rezulton se bashkësia ndërkombëtare duhet të shtojë presionin e saj pa dilemë për ndrprerjen e menjëhershme të funksionimit të këtyre strukturave në zhbërjen e tyre. Me këtë sigurisht se do të hapen perspektivat e komunikimit të lirshëm dhe të integrimit të të gjithë qytetarëve të Kosovës në veprimtaritë si në ato institucionale ashtu edhe në jetën e përgjithshme. Në të kundërtën, vazhdimi i funksionimit të tyre kësisoj dhe që reflekton vazhdimisht edhe me pozicione të dyzuara edhe në vetë strukturën e institucioneve – rrezikon që Kosova dhe qytetarët e saj në përgjithësi të mos arrijnë të përmbushin objektivat themelore të parapara edhe me Standardet për Kosovën si pjesë*

*e kushtit konstruktiv për integrimin e Kosovës në Bashkësinë Evropiane, përmbushur edhe këto kritere.*

*Mendoj se Kuvendi i Kosovës duhet të mbështetë fuqishëm këmbënguljen e tanishme të institucioneve kombëtare për zhbërjen e këtyre strukturave, si faktor kryesor, gjë që bie në pjesën kryesore të përgjegjësive të tyre dhe njëkohësisht të mbështetë dhe inkurajojë Qeverinë e Kosovës në veprimet e saja të ardhshme për zhbërjen e këtyre strukturave. Ju falemnderit.*

***RAMUSH HARADINAJ:***

*Falemnderit zoti kryesues. Që në fillim dëshiroj të përshëndes një debat të këtillë, inicuesit dhe po ashtu parafolësit për çështjet që i cekën.*

*Në mënyrë që të mos përsëritem, unë propozoj në emrin tim po edhe të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës që ne të organizojmë një metodologji të punës rreth kësaj çështjeje.*

*Mendoj se çështja e parë, që është shumë me rëndësi që të ndodhë, është një pamje e qartë me gjendjen faktike, me statistikat ekzistuese që mund t'i posedojnë mekanizmat ndërkombëtar dhe vendor në formë të një projekti për atë se çka janë këto struktura paralele, ku ekzistojnë, si veprojnë ato dhe për efektet negative që i sjellin këto.*

*Me angazhimet e përbashkëta tani të popullit të Kosovës përmes institucioneve dhe të bashkësisë ndërkombëtare për një plan që është shumë serioz për Kosovën – të planit: Standardet për Kosovën, ne duhet të bëjmë një prerje të gjendjes ekzistuese, t'i identifikojmë të gjitha këto struktura kudoqofshin ato dhe ciladoqofshin ato dhe kësisoj, në këtë pamje të mund t'iu ofrojmë të gjithëve për njohje në radhë të parë dhe për vërtetim të një gjendje, sipas meje, e cila është duke na shkaktuar dëme në Kosovë. Për këtë edhe Parlamenti mund të ngre një Komision dhe të bashkëpunojë me të gjithë mekanizmat, me KFOR-in, me Policinë e UNMIK-ut, me UNMIK-un vetë, por edhe me shërbime të caktuara që posedojnë të dhëna sikur është OSBE, ASGJ-ia e me radhë dhe kësisoj ne të kemi pamjen tonë për strukturat paralele në Kosovë.*

*Nuk mund ta diskutojmë këtë çështje në vazhdimësi pa ua prezentaur të gjithë partnerëve dhe të gjithë të interesuarve gjendjen faktike se çka po ndodhë në Kosovë, a ekzistojnë këto struktura, çfarë janë ato dhe konkretisht t'mund ta dëshmojmë këtë.*

*Si çështje e dytë, që mendoj është shumë me rëndësi për ne në Kosovë, është se ne duhet të marrim një qëndrim lidhur me këtë gjendje, lidhur me këto struktura në institucionet e Kosovës, duke filluar nga Presidenca, nga Parlamenti dhe nga Qeveria.*

*Meqë jemi në Parlament, propozoj që Parlamenti të nxjerrë një akt - pra pas prezentimit të qartë të kësaj gjendjeje dhe bashkimit të të gjitha materialeve – natyrshëm për zhbërjen e këtyre strukturave.*

*Dhe si veprim të tretë, propozoj një plan edhe me afate kohore që do të ndërlidhej me mesin e vitit 2005 për zhbërjen e këtyre strukturave. Do të thotë një plan të përbashkët me bashkësinë ndërkombëtare, plan që do të rezultonte në të njëjtën kohë edhe me realizimin e Standardeve për Kosovën. Pra që do të ishte në harmoni dhe do t'i jipte mbështetje angazhimeve tona në Kosovë për realizimin e standardeve për Kosovën deri në kohën e paraparë. Mendoj se Parlamenti i Kosovës ka një situatë tani të qëndrueshme që të veprojë në këtë drejtim.*

*Dhe po ashtu këtu duhet të theksoj ose të shtoj se është për t'u habitur pozicioni i kolegëve tanë nga Koalicioni "Kthimi" të cilët nuk po japin kontributin shumë të nevojshëm, kontribut i cili del edhe nga obligimi që kanë duke qenë deputetë në këtë Parlament - për mbështetjen e zhbërjes së këtyre strukturave. Pra këtyre duhet t'iu kërkohet një qëndrim se a janë këta vetë struktura paralele - apo do t'i mbështesin institucionet e Kosovës dhe të gjithë mekanizmat ndërkombëtar në Kosovë - për zhbërjen e tyre. Ju falemnderit.*

***KRYESUESI HYDAJET HYSENI:***

*Meqë s'ishte i kyçur mikrofoni, po e përsëris, fjalën e ka zonja Nekibe Kelmendi dhe le t'përgatitet Ismajl Kurteshi.*

***NEKIBE KELMENDI:***

*I nderuari zoti kryesues, të nderuar kolegë deputetë,*

*Edhe unë desha me dy-tri fjali, të them të zgjeruara, të shpreh mendimin tim lidhur me funksionimin e strukturave paralele serbe në Kosovë.*

*Qysh në momentin kur në korrik të vitit 1999 u vendosën telat me gjemba mbi Urën e lumit Ibër në Mitrovicë u pa qartë se do të pasojë fillimi i themelimit dhe i funksionimit të strukturave paralele në Kosovën e administruar atëherë qindpërqind nga UNMIK-u. Kjo u mundësua me lejimin e themelimit të komunës së Zveçanit e cila komunë është themeluar pas suprimimit të autonomisë së Kosovës – është themeluar në gjysmën e vitit të parë të vitit 90 për motive diskriminuese.*

*Përkundër shqetësimeve që kam shprehur publikisht kundër funksionimit të kësaj komune me struktura paralele të instaluara nga regjimi i Beogradit, e të cilat asnjëherë, dhe as sot e kësaj dite nuk e njohin UNMIK-un dhe institucionet që ai i ngriti dhe prej se është në Kosovë iu ka bërë thirrje minoritarëve serb që të inkuadrohen në institucionet kosovare, UNMIK-u nuk ka bërë përpjekje serioze që të shpërbëhen këto struktura. Sado që atëherë arsyetohej me mungesën e sigurisë së lëvizjes së këtij minoriteti nëpër territorin e Kosovës, të cilat lëvizje mbase në ato kohëra të pasluftës nuk ishin të sigurta as për popullin shumicë, me fillimin e instalimit dhe të funksionimit të strukturave paralele cenohej dhe po cenohet tërësia territoriale e Kosovës si dhe ushtrimi i pushtetit si të institucioneve të cilat janë përgjegjësi e UNMIK-ut po ashtu edhe të institucioneve të cilat janë përgjegjësi e institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës.*

*Ka shembuj të shumtë të cilët e ilustrojnë funksionimin e strukturave paralele, por shikimi i tyre me sy të mbyllur nga ana e atyre që kanë pushtetin real dhe juridik për shuarjen e këtyre strukturave, apo thënë shkurt - tolerimi i funksionimit të tyre për një kohë kaq të gjatë – i sjell në pikëpyetje jo vetëm të arriturat e gjertanishme, por edhe procesin e mëtejm të ndërtimit dhe të demokratizimit të institucioneve të Kosovës dhe kalimin e kompetencave në këto institucione.*

*Ndonëse faktet notore s'duhet argumentuar, faktin se ekzistojnë dhe funksionojnë strukturat paralele serbe në Kosovë - të mbështetura dhe të financuara nga Beogradi por edhe nga buxheti i konsoliduar i Kosovës - e argumentojnë Raporti i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian – Misioini në Kosovë, datë 10 tetor 2003, i cili ka identifikuar se në Kosovë ekzistojnë dhe funksionojnë struktura paralele në fushën e sigurisë, në fushën e sistemit gjyqësor, në fushën e çështjeve pronësore-juridike, të arsimit, të shëndetësisë, të shërbimeve publike, e unë do të shtoja: edhe në fushën e privatizimit, të ekonomisë, në sistemin e PTT, në sistemin bankar, në shërbimet kundër zbulimit e tjera.*

*Gjithashtu, në këto struktura, duke iu referuar Raportit të OSBE, bën pjesë edhe "Qendra koordinuese për Kosovën", shih Raportin – pjesa hyrëse e OSBE e cila strukturë qendër është themeluar në verë të vitit 2001 vetëm nga Qeveria e Serbisë dhe Qeveria e atëhershme e Jugosllavisë dhe nuk ështё pranuar asnjëherë nga UNMIK-u por faktikisht tash po pranohet meqenëse po pranohet edhe për bashkëbiseduese.*

*Dokumenti dhe fakti tjetër me rëndësi, është se edhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, në fjalimin e tij të fundit për situatën në Kosovë, jo vetëm që e konfirmoi por edhe kërkoi që këto struktura të shpërbëhen. Prandaj, dihet se UNMIK-u është ai i cili duhet t'i zbatojë kërkesat e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.*

*Prandaj ne deputetët e Grupit Parlamentar të LDK,*

- *duke u nisur nga fakti se nga të gjithë kosovarët - pra edhe nga minoriteti serb - kërkohet që të përmbushen Standardet për Kosovën, të parashtruara nga bashkësia ndërkombëtare para se të vendoset për statusin final të Kosovës;*
- *duke u nisur nga fakti se populli shqiptar dhe minoritetet tjera të cilat i pranojnë institucionet kosovare dhe ato të UNMIK-ut përkatësisht nuk i pranojnë strukturat paralele serbe;*
- *duke u nisur nga përcaktimi i popullit të Kosovës për ndërtimin e institucioneve demokratike funksionale, për sundimin e ligjit dhe funksionimin e shtetit ligjor, për lirinë e lëvizjes për të gjithë qytetarët e Kosovës, për kthimin e të zhvendosurve nga Kosova pa dallim përkatësie etnike, për rrespektimin e të drejtave të minoriteteve të garantuara me konventat ndërkombëtare, për rivitalizimin dhe ndërtimin e ekonomisë së tregut, për rrespektimin e të drejtave pronësore si të drejta të garantuara edhe me Kartën e Kombeve të Bashkuara, për rrespektimin e institucionit të dialogut si një instrument më frytdhënës për zgjidhjen e të gjitha çështjeve të hapura, sidomos të atyre që rrezikojnë paqën dhe sigurinë në rajon, për mbështetjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe ndihmën që duhet ofruar për t'i realizuar ato objektiva që veti i kanë parashtruar:*

*Do të propozojmë që Kryesia e Kuvendit të Kosovës të kërkojë nga UNMIK-u të hartojë një politikë koherente të cilën politikë do ta bëjë transparente për shpërndarjen e strukturave paralele në Kosovë - të cilat janë dhe do të jenë bllokuese të çdo progresi për Kosovën dhe për integrimet e saj në strukturat Evro-Atlantike.*

*Gjithashtu të kërkohet nga UNMIK-u që zbatimi i kësaj politike të shkojë – në mos përpara – atëherë paralelisht me përmbushjen e standardeve për Kosovën.*

*Në të kundërtën, kosovarët dhe isntitucionet e vetëqeverisjes së përkohshme - heqin nga veti çdo lloj përgjegjësie për zvarritjen, për pasojat e mospërmbushjes së këtyre standardeve apo për dështimin e politikës së UNMIK-ut në Kosovë. Ju falemnderit.*

***KRYESUESI HYDAJET HYSENI:***

*Falënderojmë zonjën Kelmendi. Fjalën e ka deputeti Ismajl Kurteshi, le të përgatitet deputeti Muhamet Kelmendi. Po tërheq vërejtjen se kemi vështirësi me kuorumin qysh tani.*

*ISMAJL KURTESHI:*

*I nderuari zoti kryesues, deputetë të nderuar,*

*Dëshiroj t'ju përkujtoj se zoti Hollkeri gjatë takimit me liderët kosovar më 14 janar të këtij viti, kur i shpalosi prioritetet e UNMIK-ut për vitin 2004 patë thënë se – prioritet i parë i UNMIK-ut është përmbushja e standardeve për Kosovën duke e veçuar rrespektimin e ligjit si standard të një rëndësie të veçantë.*

*Mendoj se këtyre standardeve duhet t'i shtohet edhe një standard e ai duhet të jetë: standardi për shuarjen e strukturave ilegale paralele në Kosovë, pasi që neni 1.2 i Kornizës kushtetuese Kosovën e njeh si territor të pandashëm, kurse institucioneve të Kosovës ua njeh të drejtën për administrim të Kosovës.*

*Se UNMIK-u nuk e ka përmbushur këtë obligim kushtetues dhe se një pjesë e Kosovës po administrohet nga strukturat ilegale paralele serbe, që nuk e kanë njohur asnjëherë adminsitratën e UNMIK-ut e as institucionet e Kosovës por janë të lidhura drejtpërdrejt me Beogradin – dëshmojnë faktet në vijim:*

- *menjëherë pas luftës serbët e Kosovës organizuan sistem paralel në arsim, shëndetësi,*
- *drejtësi dhe adminsitratë;*
- *vitin e kaluar ata themeluan bashkësitë e komunave serbe në veri të Kosovës dhe në Anamoravë;*
- *tani po i emërojnë koordinatorët e këshillave komunale;*
- *shkollat në gjuhën serbe po i shfrytëzojnë planprogamet, dokumentacionet dhe vulat e Ministrisë së arsimit të Serbisë;*
- *e njëjta gjendje është edhe në shëndetësi;*
- *gjykatat paralele funksionojnë në Mitrovicë, Leposaviq, Zubin-Potok, Zveçan, Lepinjë, Shterpcë e të tjera;*
- *Ministria e punëve të brendshme e Serbisë i ka zyrat e veta në të gjitha pjesët e Kosovës. Këto zyra lëshojnë pasaporta, patentshoferë, letërnjoftime, tabela të regjistrimit e dokumenta të tjerë të cilat i njeh edhe UNMIK-u.*

*Të gjitha këto struktura ilegale paralele, me insistimin e UNMIK-ut, financohen nga buxheti i Kosovës, por ato i përkrahë materialisht edhe Qeveria e Serbisë. Ndaj të gjitha këtyre veprimeve UNMIK-u është mjafuar me deklarata të kohëpaskohshme se nuk i pranon këto struktura ilegale, por në fakt nuk ka ndërmarrë asgjë për pengimin e veprimit apo zhbërjen e tyre. Në fakt UNMIK-u po e mundëson funksionimin e tyre dhe po bashkëpunon me to.*

*Në këtë situatë OSBE-a i ka sygjeruar UNMIK-ut që institucionet e Kosovës të bisedojnë me Beogradin zyrtar në lidhje me këto struktura ilegale. OSBE po ashtu ka rekomanduar që të njihen vendimet e gjykatave ilegale, e të pranohen si legjitime disa aktivitete të Ministrisë së punëve të brendshme të Serbisë. Janë bërë përpjekje që këto struktura të inkorporohen në institucionet e Kosovës, prandaj procedura për pranimin e "rojeve të urës" në Shërbimin Policor të Kosovës ka qenë më i thjeshtë se ajo e zakonshmja. Nga 42 policë serb në Shërbimin Policor të Kosovës në Mitrovicë 19 janë ish pjesëtar të Ministrisë së punëve të brendshme të Serbisë. Të gjitha këto dhe sygjerimet tjera të OSBE janë në kundërshtim me Kornizën kushtetuese.*

*Në Kreun 12 të Kornizës kushtetuese, në lidhje me kompetencat e administratorit, ndër të tjera thuhet: Ai mbikëqyrë institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, zyrtarët dhe organizmat e tyre*

*dhe merr masa të duhura kurdo që veprimet e tyre janë të papajtueshme me këtë Kornizë kushtetuese.*

*UNMIK-u dhe institucionet e Kosovës duhet të angazhohen për rrespektimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe të pakicave kombëtare të të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa përjashtim. Por, është koha e fundit që kryeadminsitratori të veprojë në përputhje me kompetencat dhe obligimet që dalin nga Korniza. Toleranca e zotit Hollkeri dhe e parardhësve të tij, në raport me strukturat ilegale serbe dhe heshtja e pakuptimt e institucioneve të Kosovës kanë bërë që një pjesë e madhe e Kosovës të kontrollohet nga Serbia.*

*Pasojat e mosveprimit të UNMIK-ut dhe mosinsistimit të institucioneve tona për shuarjen e këtyre strukturave ilegale paralele janë shumë të dëmshme. Prandaj, ky Kuvend duhet sot të kërkojë me ngulm nga zoti Hollkeri që ta përmbushë obligimin e tij kushtetues, që do të thotë: vuarjen nën kontroll të tërë territorit të Kosovës, shpalljen ilegale të strukturave paralele serbe dhe ndërprerjen e çfarëdo bashkëpunimi me to.*

*Kuvendi i Kosovës duhet të kërkojë nga institucionet e Kosovës që asesi të mos kontaktojnë me strukturat ilegale paralele duke përfshirë këtu edhe të ashtuquajturin "këshill koordinues për Kosovën", tua ndërpresë financimin të gjitha strukturave paralele, t'i shpallë të pavlefshme të gjitha dokumentet e lëshuara pas luftës nga ato struktura, si dhe t'i largojë nga institucionet e Kosovës të gjithë ata që vazhdojnë edhe më tutje të jenë të involvuar në strukturat paralele serbe. Ju falemnderit.*

***KRYESUESI HYDAJET HYSENI:***

*Fjalën e ka deputeti Muhamet Kelmendi, le të përgatitet Naim Maloku. Deputetëve ua tërheq vërejtjen me të drejtë se koha për diskutim është e kufizuar në 5 minuta.*

***MUHAMET KELMENDI:***

*I nderuar zoti kryesues, zonja dhe zotërinj,*

*S'është mirë që të tërheqsh vërejtjen pikërisht tash kur të merr një deputetë fjalën dhe jo pak më parë, a kupton, kur t'i jipet fjala, atëherë duhet të veprohet ndaj të gjithëve në formën e njëjtë. Megjithatë, të falemnderit.*

*Zoti kryesues, është mirë dhe përshëndes kërkesën e Grupit Parlamentar i cili ka dalë me një çështje jashtëzakonisht të rëndësishme sepse është një çështje jetike dhe e lidhur po ashtu drejtpërdrejtë edhe me një standard të veçantë mbi të cilin duhet të përmbushet siç thotë faktori ndërkombëtar për të ecur në drejtim të përmbushjes së tyre dhe të zgjidhet statusi përfundimtar i Kosovës.*

*Megjithatë, neve kjo nuk na arsyeton në punën e deritashme të cilën e ka bërë ky Kuvend ku gjendemi sot ne, institucionet e Kosovës dhe në veçanti mund të themi edhe faktori ndërkombëtar – UNMIK-u.*

*Ne jemi dëshmitarë të një Rezolute të cilën ky Kuvend para një viti e gjysmë – dy vite e ka nxjerrë lidhur me këtë çështje dhe ajo ka pasë jetë diku rreth një ore e pastaj është anuluar nga faktori ndërkombëtar dhe pothuajse fare deri më tash ne nuk jemi marrë me këtë çështje, edhe pse ka qenë çështje jashtëzakonisht e rëndësishme dhe mendoj se Kuvendi është dashur të mirret në mënyrë kryesisht ekzofit, që don të thotë mbi bazën juridike dhe të kompetencave të veta që i*

*ka – për të parë pse u anulua ajo Rezolutë, ku është fati i saj dhe për të bërë punën e vet në drejtim të shtrirjes së pushtetit të tij në tërësi në Kosovë.*

*Megjithatë unë e shoh të rrugës dhe të mirë këtë çështje. Mirëpo, mendoj se ne mundemi këtu të diskutojmë nëpërmjet informacioneve të ndryshme që çdo deputet i ka marrë nga mjetet e informimit ose nga njerëzit e vet në terren.*

*Është e domosdoshme që të bëhet një raport me shkrim, mendoj unë, nga institucionet e Kosovës, në këtë rast Qeveria e Kosovës e cila do t'na i tregojë neve drejtpërsëdrejti vështirësitë dhe në cilat fusha shtrihet ai pushtet, sepse unë mendoj kemi të bëjmë me një pushtim të një territori të Kosovës, në këtë rast një të tretës nga Serbia ku në tërësi aty ekziston pushteti i ish Milloshevigit dhe nuk ka asnjë lloj ndryshimi përveç një agresioni jashtëzakonisht të ashpër dhe pushtues mbi territorin tonë. Prandaj, Qeveria duhet në mënyrë më kompetente të tregojë se si është gjendja, në mënyrë që pastaj n e t ë d iskutojmë këtu d he të nxjerrim q ëndrime a dekuate s e si d uhet t ë mënjanohen ato.*

*Askush s'mund ta bindë qytetarin e Kosovës se faktori ndërkombëtar - në këtë rast KFOR-i, i cili është atje Francez dhe U NMIK-u - se nuk janë në gjendje me një vendim jashtëzakonisht t ë shpejtë t'i mënjanojë këto struktura paralele. Po qe se do t'i ndodhë një rast i tillë UNMIK-ut në një vend tjetër ku do të jenë shqiptarët në pushtet dhe do të krijonte një strukturë paralele të Shqipërisë, unë jam i sigurt se brenda 24 orëve me vendim të veçantë dhe me masa të jashtëzakonshme, qoftë policore-ushtarak, do të hiqeshin ato. Prandaj, është alogjike se nuk ka mundësi faktori ndërkombëtar – në këtë radhë UNMIK-u që me vendimet e veçanta t'i shpallë ato jo vetëm ilegale e ta ndalojë veprimin, por edhe të marrë masa juridike e penale deri tek dënimi i atyre ekzekutuesve dhe organizatorëve të veprimtarisë së tillë, sepse është një ndër shkaqet më të rënda në drejtim të realizimit të të ardhmes së Kosovës.*

*Prandaj, mendoj se ky Kuvend duhet ta ftojë në mënyrë zyrtare Qeverinë e Kosovës të raportojë këtu dhe të vazhdohet pastaj në një seancë tjetër të veçantë lidhur me këtë çështje, të nxirret një rezolutë dhe të kërkohet nga faktori ndërkombëtar sakt, sidomos pjesa e standardit që ka të bëjë me integrimin e minoritetit serb në Kosovë - mos të futet në analizat e mëtejshme në lidhje me këtë në qoftë se nuk mënjanohen nga faktori ndërkombëtar këto struktura paralele, apo më mirë me thënë në qoftë se nuk hiqet pushtimi i Kosovës, i pjesës së Kosovës, nga ana e Serbisë dhe klikës së Milloshevigit e cila, sipas mendimit tim, atje është në fuqi. Dhe në këtë drejtim mendoj se është detyrë e të gjitha organeve të Kosovës, pra në këtë rast edhe të kryetarit të Kosovës zotit Rugova, Qeverisë dhe të institucioneve tjera që së bashku të vijnë këtu, së bashku të nxirren jo vetëm rezoluta por edhe vendime dhe së bashku të kërkojmë nga faktori ndërkombëtar që njëherë e përgjithmonë të çlirohet pjesa e pushtuar e Kosovës. Ju falemnderit.*

*NAIM MALOKU:*

*Të falemnderit zoti kryesues. Të nderuar deputetë,*

*Mora fjalën për të tërheq edhe unë një vërejtje për atë që ishte një propozim i inicuesit të kësaj teme të rendit të ditës – në emër të Grupit Parlamentar të PDK që sot të debatohet apo të mirren qëndrime vetëm në emër të grupeve parlamentare dhe të përgatitet një seancë e veçantë për këtë temë sa të ndieshme aq edhe të rëndësishme për Parlamentin e Kosovës dhe për Kosovën në*

*tërësi dhe në të cilën seancë do t'u ftonin edhe përfaqësuesit e UNMIK-ut, të Qeverisë dhe ndoshta edhe nga Presidenca që të raportojnë apo të marrin pjesë në debatin parlamentar.*

*Unë kisha për të sygjeruar që kjo të vëhet në votim, sepse ishte një propozim sipas mendimit tim me vend dhe edhe njëherë po e theksoj qëndrimin tim se një temë e tillë don shqyrtim më konciz, më përmbajtësor, e jo kur të ketë edhe krizë kuorumi - sepse gati as gjysma e deputetëve nuk janë të pranishëm - të debatohet për këtë temë.*

*Më lejoni të them se nëse kjo pranohet nga deputetët dhe vendoset të jetë seancë e veçantë për këtë temë, atëherë faktorit ndërkombëtar – shtyllës së parë të UNMIK-ut në atë seancë duhet t'i parashtrohen këto çështje për raportim para Kuvendit: veprimtaria e shërbimeve sekrete të ushtrisë serbe dhe të shërbimeve sekrete shtetërore serbe në Kosovë. Ne e dijmë, sepse edhe vetë shefi i shërbimit sekret të ushtrisë serbe ka deklaruar që ekziston rrjeti i atij shërbimi në Kosovë, kurse UNMIK-u nuk ka dhënë sqarime bindëse për ekzistimin apo mosekzistimin e veprimtarisë së këtyre shërbimeve......*

***(Kështu përfundon inçizimi elektronik i Seancës plenare të datës 18-19.2004)***

**PS: Për shkaqe teknike, inçizimi elektronik i Seancës plenare të datës 18-19 shkurt 2004, është i mangët. Arsyet janë të njohura meqë ishte seancë e parë me një teknikë të re elektronike dhe kjo seancë njëkohësisht është shfrytëzuar si provë dhe trajnim të deputetëve.**